



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Viti: 2019 – Numri: 41

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Tiranë – E enjte, 28 mars 2019

PËRMBAJTJA

	Faqe
Rezolutë e Kuvendit datë 21.3.2019	Për vlerësimin e veprimtarisë së Entit Rregullator të Ujit për vitin 2018..... 3451
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 120, datë 13.3.2019	Për një ndryshim në vendimin nr. 926, datë 29.12.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për kriteret e vlerësimit të pronës shtetërore që privatizohet apo transformohet dhe procedurën e shitjes”, të ndryshuar..... 3453
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 136, datë 20.3.2019	Për miratimin e nomenklaturës së klasifikimit të llojeve të ndërtimit (KN) 3454
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 137, datë 20.3.2019	Për miratimin e nomenklaturës së statistikave të transportit, NST- 2007..... 3465
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 138, datë 20.3.2019	Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 187, datë 8.3.2017, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve, zëvendësministrit dhe nëpunësve të kabineteve, në Kryeministri, aparatet e ministrive të linjës, administratën e Presidentit, Kuvendit, Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Gjykatën e Lartë, Prokurorinë e Përgjithshme, disa institucione të pavarura, institucionet në varësi të Kryeministrit, institucionet në varësi të ministrave të linjës dhe administratën e Prefektit”, të ndryshuar..... 3470
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 139, datë 20.3.2019	Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 867, datë 10.12.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për procedurat e bashkëpunimit në institucionet e administratës shtetërore”..... 3473
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 140, datë 20.3.2019	Për miratimin e paraqitjes, të formës dhe të shenjave dalluese të uniformës, në njësi të veçanta të Shërbimit Informativ të Shtetit..... 3473
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 141, datë 20.3.2019	Për disa ndryshime në vendimin nr. 718, datë 29.10.2004, të Këshillit të Ministrave, “Për listën e personave të shpallur si financues të terrorizmit”, të ndryshuar..... 3479

Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 142, datë 20.3.2019	Për kalimin në pronësi, nga Ministria e Mbrojtjes të Bashkia Tiranë, të një sipërfaqeje trualli funksional dhe objekti, brenda territorit të pronës nr. 42, me emërtim “Instituti i Studimeve dhe Projektive të Mbrojtjes”, me vendndodhje bulevardi “Zhan D’Arkë”, Tiranë, disa ndryshime në vendimin nr. 572, datë 3.9.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për dhënien në përdorim të përkohshëm, nga Ministria e Mbrojtjes Ministrisë së Punëve të Brendshme, të objektit nr. 42, me emërtim “Instituti i Studimeve dhe Projektive të Mbrojtjes”, për Shkollën Shqiptare të Administratës Publike, dhe shfuqizimin e vendimit nr. 786, datë 14.11.2012, të Këshillit të Ministrave”, dhe në vendimin nr. 515, datë 18.7.2003, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Mbrojtjes”, të ndryshuar.....	3479
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 143, datë 20.3.2019	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarit të pasurisë së paluajtshme, pronë private, që preket nga realizimi i projektit “Rikonstruksion i rrugës Unaza Patos”, në Bashkinë Patos.....	3482
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 144, datë 20.3.2019	Për miratimin e marrëveshjes së financimit, ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë (Marrësi) dhe KfW Frankfurt am Main (KfW), për financimin e Shërbimeve Ndërkombëtare Këshillimore për menaxhim për masa shoqëruese në kuadër të programit “Linja unazore 110 kV e Shqipërisë së Jugut”	3483
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 146, datë 20.3.2019	Për miratimin e kontratës së koncesionit/partneritet publik privat, ndërmjet Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë “Global Technical Mechanics” sh.p.k. dhe “Bami” sh.p.k., si koncesionari dhe shoqërisë koncesionare “Kukës International Airport” sh.p.k., për rehabilitimin, operimin, transferimin e Aeroportit të Kukësit.....	3487
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 148, datë 20.3.2019	Për procedurën që zbaton shërbimi i provës në rast të mospërbushjes së masës alternative të shmangies nga ndjekja penale.....	3487
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 149, datë 20.3.2019	Për krijimin, organizimin, funksionimin, karakteristikate përdorimit e aksesimit, të dhënat parësore e dytësore dhe dhënësin e informacionit të Sistemit të Integruar të të Dhënave të Drejtësisë Penale për të Mitur.....	3489
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 150, datë 20.3.2019	Për metodologjinë e llogaritjes së fondeve për financimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror.....	3492
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 151, datë 20.3.2019	Për heqjen nga fondi pyjor publik dhe zvogëlimin në volum të sipërfaqes prej 1.1833 ha, në objektin “Maja e Midhës”, të Bashkisë Fushë-Arrëz, që do të përdoret nga Ministria e Mbrojtjes për ndërtimin e radarit SIVHA.....	3496
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 152, datë 20.3.2019	Për heqjen nga fondi pyjor dhe kullor publik dhe zvogëlimin në volum të sipërfaqes prej 12 ha, që do të përdoret nga “Devoll hydropower” sh.a., për shfrytëzimin e gurit gëlqeror në objektin “Popçisht”, Bashkia Maliq.....	3499
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 153, datë 20.3.2019	Për dhënien e statusit të veçantë “Investitor në strukturë akomoduese me 5 vje, status special”, aplikuesit “Tirana Business Park” sh.p.k.....	3501



**REZOLUTË
PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË
SË ENTIT RREGULLATOR TË UJIT
PËR VITIN 2018**

Kuvendi i Shqipërisë:

Duke njohur Entin Rregullator të Ujit si një institucion të pavarur publik, përgjegjës për rregullimin dhe mbikëqyrjen e sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura në nivel kombëtar;

Duke vlerësuar që në fund të vitit 2018, si rezultat i reformës, vihet re një përmirësim i lehtë i gjendjes financiare të sektorit UK, veçanërisht në drejtim të:

- eliminimit të lidhjeve të paligjshme, si rezultat i aksionit të ndërmarrë në nivel kombëtar, gjë e cila ndikoi edhe në rritjen e numrit të klientëve;

- rritjes së numrit të ujëmatësve të vendosur, gjë e cila ndikoi edhe në përmirësimin e treguesit të nivelit të matjes;

- arkëtimeve të debive të prapambetura;

Duke theksuar njëkohësisht që këto arritje nuk përmbushën pritshmëritë e parashikuara nga reforma, sidomos në drejtim të uljes së humbjeve nga eliminimi i lidhjeve të paligjshme;

Duke theksuar se ndryshimet ligjore të nevojshme, me gjithë periudhën disave vite që diskutohen, ende nuk janë realizuar, si dhe duke nxitur Qeverinë dhe gjithë aktorët për të propozuar sa më parë ndryshimet ligjore, të cilat pritet të kenë një impakt pozitiv si në sektorin e UK-së, ashtu edhe në lidhje me pavarësinë institucionale dhe operationale të ERRU-së, rolit të saj në lidhje me mbrojtjen e konsumatorit, përcaktimin e saktë të kompetencave dhe shmangien e mbivendosjes së kompetencave, rritjen e efektivitetit etj.;

Duke pasur parasysh që reforma territoriale, e ndjekur nga reforma në sektorin e UK-së i ka dhënë më shumë përgjegjësi dhe kompetencë bashkive përmes “një bashki një ujësjellës”, duke rritur mundësinë e përmirësimit të këtij shërbimi jetik përmes përdorimit të ekonomisë së shkallës;

Duke pasur parasysh që mungesa e furnizimit të vazhdueshëm dhe tendenca negative e këtij treguesi vijon të mbetet problem shqetësues, duke ndikuar edhe në cilësinë e ujit;

Duke theksuar se besueshmëria e të dhënave

në sektorin UK vijon të mbetet problematike, duke sjellë në disa raste tregues performance kontradiktore e me diferenca të ndjeshme;

Duke theksuar se me gjithë përpjekjet e bëra, ende nuk janë bërë ndryshimet e nevojshme në legjislacionin që rregullon dhënien e aktmiratimit higjieno-sanitar;

Mori në shqyrtim veprimtarinë e Entit Rregullator të Ujit dhe:

Duke vlerësuar përmirësimin e treguesit “Mbulimi i kostove O&M” me 15% krahasuar me një vit më parë, tregues i cili tregon për përmirësim të aspekteve të menaxhimit nga stafi drejtues i shoqërive UK;

Duke vlerësuar rritjen e “Nivelit të matjes” me 5% krahasuar me një vit më parë, përmirësim i cili ka ardhur si rezultat i investimeve në sektor kryesisht nga lidhjet e reja për shkak të riorganizimit;

Duke vlerësuar punën e bërë nga ERRU-ja gjatë vitit 2018, për mbledhjen e detyrimeve të prapambetura të pagesave rregullatore vjetore dhe ato për licencime që duhet të paguajnë shoqëritë UK;

Duke vlerësuar Memorandumin e Mirëkuptimit të firmosur mes ERRU-së dhe Autoritetit të Konkurrencës në vitin 2018, me qëllim bashkëpunimin mes tyre për mbrojtjen dhe garantimin e mbrojtjen e interesave publikë ndaj abuzimeve për shërbimet monopol, si dhe krijimin e një mjedisi transparent ligjor në sektorin e ujësjellës kanalizimeve;

Duke qenë se saktësia e të dhënave vijon të mbetet problem në llogaritjen e treguesve të performancës, si dhe në hartimin e bilanceve të sakta të ujit si bazë e planeve 5-vjeçare të biznesit të shoqërive UK;

Duke qenë se norma e arkëtimit në vitin 2018 vijon të mbetet pothuaj e njëjtë me atë të një viti më parë pas rënies së ndjeshme që pësoi krahasuar me vitin 2016;

Duke pasur parasysh rëndësinë dhe ndjeshmërinë e këtij sektori, si dhe të drejtën e çdo qytetari për të pasur shërbim të furnizimit me ujë dhe largimit të ujërave të ndotura;

Duke vlerësuar punën e bërë për hartimin e “Rregullores së re për organizimin e seancës dëgjimore me publikun”, e cila rrit seriozitetin dhe përgjegjësinë e seancave dëgjimore me publikun dhe, gjithashtu, e bën atë një mjet më



efikas dhe komunikues në funksion të konsumatorit, lidhur me problematikat e shërbimeve, si dhe të tarifave që operatori propozon të aplikojë;

Duke vlerësuar rritjen e numrit të ankesave të ardhura në ERRU gjatë vitit 2018 (megjithëse mbetet ende i ulët, duke pasur parasysh problematikat e konsumatorëve), 39 ankesa të ardhura kryesisht nga konsumatorë familjarë, numër ky më i lartë krahasuar me vitin 2017 (17 ankesa në 9-mujorin e parë) gjë që tregon rritjen e besimit tek ERRU-ja, pavarësisht rolit ndërmjetësues që ERRU-ja ka me dispozitat ligjore në fuqi;

Kërkon nga Enti Rregullator i Ujit, për vitin 2019, të angazhohet në këto drejtime:

Në kuadër të reformës, të luajë një rol aktiv dhe nxitës, në mënyrë që të bëhet i mundur realizimi i shembujve pilot të agregimit (bashkimit) të disa shoqërive UK në sektor, agregimi (bashkimi) i shoqërive do të bënte të mundur përdorimin e ekonomisë së shkallës me ndikim të drejtpërdrejtë në uljen e kostove dhe lehtësi në thithjen e fondeve të BE-së për këtë sektor, në hapat e mëtejshëm të integritimit të vendit.

Me gjithë tendencën e lehtë rënëse të 3 viteve të fundit të “Ujit pa të ardhura”, ky tregues vijon të mbetet në shifra tepër të larta, ndaj ERRU-së, përmes politikave të tarifimit, të ushtrijë presion mbi shoqëritë UK, duke kërkuar nga shoqëritë UK plane veprimi të detajuara konkrete dhe të matshme për përmirësimin e këtij treguesi shumë të rëndësishëm.

Të kërkojë nga shoqëritë UK argumentim të plotë e të saktë mbi numrin e punonjësve dhe përshkrimin e detajuar të punës për secilin pozicion të stafit të saj dhe njëkohësisht të nxisë një përdorim më të madh të teknologjisë në sektorin UK, në mënyrë të veçantë për të bërë të mundur zëvendësimin e shërbimit të sigurisë fizike përmes sistemeve monitoruese CCTV, gjë e cila ndikon në rritjen e eficiencës së stafit, tregues i cili, me gjithë përmirësimin e lehtë, vijon të mbetet i lartë.

ERRU-ja, nga njëra anë, të nxisë shoqëritë UK që të marrin masa për instalimin e matësve në burim dhe, nga ana tjetër, të bashkëpunojë me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Agjencinë Kombëtare të Ujësjellës Kanalizimeve dhe Infrastrukturës së Mbetjeve (AKUM) për

implementimin e planit të punës për pajisjen e të gjitha shoqërive me ujëmatës të mëdhenj.

ERRU, përmes të gjitha instrumenteve ligjore që disponon, të kërkojë nga shoqëritë UK rritjen e normës së arkëtimit, si një tregues i cili ka lidhje të drejtpërdrejtë me përmirësimin e gjendjes financiare të shoqërive UK.

Në kuadër të mbrojtjes së interesave të konsumatorëve për garantimin e një zgjidhjeje sa më të drejtë dhe efektive të ankesave të konsumatorëve, të miratojë “Rregulloren për trajtimin e ankesave të konsumatorëve”, e cila ishte e përfshirë në objektivat dhe rekomandimet e vitit 2018.

ERRU-ja, në kuadër të mbrojtjes së konsumatorit, të ketë gjithmonë në konsideratë faktorin e përballeshmërisë në aprovimin e tarifave.

Të rrisë përpjekjet për promovimin e institucionit përmes mjeteve të informimit publik, si dhe mediave sociale, për të bërë të mundur ndërgjegjësimin e konsumatorëve për të drejtat e tyre dhe rolin e ERRU-së për mbrojtjen e interesave të konsumatorit.

ERRU-ja të vlerësojë me seriozitet dhe përgjegjshmëri rekomandimet e bëra nga institucione të tjera lidhur me vendimmarrjen e ERRU-së apo me sektorin e UK-së, në mënyrë të veçantë nga Autoriteti i Konkurrencës, me të cilin ka tashmë edhe një Memorandum Mirëkuptimi.

Të finalizojë dhe të miratojë sa më parë “Metodologjinë e vendosjes së tarifave”, duke iu referuar edhe eksperiencave më të mira ndërkombëtare nga konsultimi me Shoqatën e Rregullatorëve të Evropës WAREG, kjo metodologji ishte e përfshirë në objektivat dhe rekomandimet e vitit 2018.

Të marrë pjesë aktive, me propozime konkrete, dhe të bashkëpunojë ngushtësisht me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe aktorët e tjerë për hartimin e ndryshimeve ligjore, të cilat, megjithëse të vonuara, pritet të sjellin një përcaktim më të qartë të statusit ligjor të ERRU-së, si dhe një dimension të ri lidhur me rolin e tij si institucion i pavarur në sektorin UK.

Miratuar në datën 21.3.2019.

**KRYETARI
Gramoz Ruçi**

**VENDIM****Nr. 120, datë 13.3.2019**

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN
NR. 926, DATË 29.12.2014, TË KËSHILLIT
TË MINISTRAVE, “PËR KRITERET E
VLERËSIMIT TË PRONËS
SHTETËRORE QË PRIVATIZOHET
APO TRANSFORMOHET DHE
PROCEDURËN E SHITJES”,
TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 2, të aktit normativ nr. 4, datë 9.7.2008, “Për privatizimin dhe dhënien në përdorim të shoqërive tregtare dhe institucioneve shtetërore, të ndërmarrjeve apo objekteve të veçanta, mjeteve kryesore dhe mjeteve të xhiros të këtyre ndërmarrjeve”, miratuar me ligjin nr. 9967, datë 24.7.2008, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Pika 32, e kreut III, “Procedura e shitjes së pronës shtetërore”, të vendimit nr. 926, datë 29.12.2014, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, riformulohet si më poshtë vijon:

“32. Pasuritë shtetërore, të dhëna me kontratë qiraje ose enfiteozë, me sipërfaqe mbi 500 (pesëqind) m², i shiten në mënyrë të drejtpërdrejtë kontraktuesit nga Drejtoria e Drejtimit të Pronës Publike, sipas përcaktimeve të objektit të kontratës (objekt, truall nënobjekt, truall funksional, linja teknologjike, makineri, pajisje etj.):

a) pasi është konsumuar, të paktën, mbi 5 (pesë) vjet kontrata; në rast se vlera e investimit të kryer prej tij është mbi 150 (njëqind e pesëdhjetë) për qind të vlerës së truallit dhe kur nga ana e kontraktuesit janë respektuar kushtet e kontratës dhe ai nuk ka detyrime ndaj shtetit;

b) pa u përmbushur afati prej 5 (pesë) vitesh i konsumimit të kontratës, në rast se vlera e investimit të kryer prej tij është mbi 750 (shtatëqind e pesëdhjetë) për qind të vlerës së truallit; nga ana e kontraktuesit janë respektuar kushtet e tjera të kontratës dhe ai nuk ka detyrime ndaj shtetit.

Pasi investimet e kryera nga kontraktuesi janë miratuar nga ministri përgjegjës për ekonominë,

ky i fundit urdhëron vazhdimin e procedurave të privatizimit për shitje të drejtpërdrejtë, sipas objektit të kontratës (objekt, truall nënobjekt, truall funksional, linja teknologjike, makineri, pajisje etj.) dhe ngre komisionin e vlerësimit, sipas përcaktimeve të këtij vendimi.

Pasuritë shtetërore të dhëna me kontratë qiraje me tarifën 1 euro/kontrata, i shiten në mënyrë të drejtpërdrejtë kontraktuesit nga Drejtoria e Drejtimit të Pronës Publike, sipas përcaktimeve të objektit të kontratës (objekt, truall nënobjekt, truall funksional, linja teknologjike, makineri, pajisje etj.):

a) pasi është konsumuar, të paktën, mbi 5 (pesë) vjet kontrata, në rast se vlera e investimit të kryer prej tij është mbi 150 (njëqind e pesëdhjetë) për qind e vlerës së truallit; nga ana e kontraktuesit janë respektuar kushtet e kontratës dhe ai nuk ka detyrime ndaj shtetit;

b) në çdo kohë, nëse kontrata është e vlefshme dhe brenda afatit të përcaktuar në kontratë, në rast se vlera e investimit të kryer prej tij është mbi 750 (shtatëqind e pesëdhjetë) për qind e vlerës së truallit; nga ana e kontraktuesit janë respektuar kushtet e tjera të kontratës dhe ai nuk ka detyrime ndaj shtetit.

Pasi investimet e kryera nga kontraktuesi janë miratuar nga ministri përgjegjës për ekonominë, ky i fundit i propozon Këshillit të Ministrave dhënien e miratimit për fillimin e procedurave të privatizimit të objektit, sipas përcaktimeve të kontratës (objekt, truall nënobjekt, truall funksional, linja teknologjike, makineri, pajisje etj.), duke parashikuar edhe shfuqizimin e vendimit të Këshillit të Ministrave, që ka miratuar kontratën e qirasë me tarifën 1 euro, pas nënshkrimit të kontratës së shitjes.

Nëse Këshilli i Ministrave miraton propozimin për fillimin e procedurave të privatizimit të objektit, sipas përcaktimeve të kontratës, ministri përgjegjës për ekonominë urdhëron vazhdimin e procedurave të privatizimit për shitje të drejtpërdrejtë, sipas objektit të kontratës, dhe ngre komisionin e vlerësimit, sipas përcaktimeve të këtij vendimi.

Në rastet kur objekti i marrë me qira apo enfiteozë ose me kontratë qiraje 1 euro është shembur plotësisht dhe mbi truallin e tij është ndërtuar një objekt krejtësisht i ri, apo në rastet kur objekti të marrë me qira/enfiteozë i janë bërë



ndryshime, shtesa apo prishje të shumta (të miratuara me aktet ligjore përkatëse), që e bëjnë të vështirë vlerësimin real të tij, pasi objekti është tjetërsuar, vlerësimi i objektit të marrë me qira/enfiteozë ose me kontratë qiraje 1 euro si dhe genplani bëhen në bazë të dokumentacionit ekonomik-teknik, që disponon institucioni shtetëror, i cili e ka në administrim objektin, në bazë të çdo dokumentacioni tjetër të mundshëm, që mund t'i shërbejë këtij vlerësimi, si dhe në bazë të kontratës së qirasë/enfiteozës dhe dokumentacionit përkatës, bashkëlidhur saj (genplani, procesverbal i dorëzimit, fotografitë e objektit në momentin e marrjes me qira etj.).

Për qiramarrësit që blejnë nga Drejtoria e Drejtimit të Pronës Publike, në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, objektin shtetëror (godinën + linja teknologjike, makineri e pajisje), të cilin e kanë me qira/enfiteozë apo kontratë qiraje 1 euro, sipas përcaktimeve të kësaj pike, shlyerja e vlerës së objektit (godinës + linjës teknologjike, makineri e pajisje) bëhet deri në 80 (tetëdhjetë) për qind të vlerës së saj me bono privatizimi apo me lekë privatizimi, sipas kërkesës me shkrim, të depozituar pranë kësaj drejtorie nga blerësi i objektit. Pagesa e vlerës së truallit, për pasuritë shtetërore të dhëna me qira/enfiteozë dhe kontratë qiraje 1 euro do të bëhet vetëm me lekë.

Për rastet kur objekti ka ish-pronar truall, vlera e truallit, sipas përcaktimeve të bëra në dosjen e privatizimit, i kalon pronarit për kompensim.”.

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM

Nr. 136, datë 20.3.2019

PËR MIRATIMIN E NOMENKLATURËS SË KLASIFIKIMIT TË LLOJEVE TË NDËRTIMIT (KN)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, dhe të pikës 5, të nenit 24, të ligjit nr. 17/2018, “Për statistikat zyrtare”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e zbatimit të nomenklaturës së klasifikimit të llojeve të ndërtimit (KN), të miratuar, paraprakisht, nga Komisioni Kombëtar për Nomenklaturën, sipas lidhjes 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Nomenklatura e klasifikimit të llojeve të ndërtimit zbatohet për mbledhjen, klasifikimin dhe publikimin e të dhënave statistikore, zyrtare, për aktivitetin e ndërtimit.

3. Instituti i Statistikave kryen përditësimin e informacionit statistikor, zyrtar, duke filluar nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

4. Ngarkohen Instituti i Statistikave, agjencitë statistikore, ministrinë e linjës dhe institucionet qendrore e vendore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Erion Braçe

KLASIFIKIMI I LLOJEVE TË DËRTIMIT KN VERSIONI FINAL AL

PJESA I
HYRJE

Shënime të përgjithshme

1. Klasifikimi i Llojeve të Ndërtimit (KN) është hartuar duke u bazuar në Klasifikimin Qendror të Produkteve (KQP), versioni provizional, publikuar në vitin 1991 nga Organizata e Kombeve të Bashkuara. Sipas KQP-së, divizioni 52, “Ndërtime” ndahet në dy kategori: “Ndërtesa” dhe “Punime inxhinierike”, të cilat janë përdorur dhe në KN si grupime kryesore.

KN-ja, në të njëjtën kohë përpiqet të jetë konsistente me rekomandimet e aplikuara në këtë fushë nga Organizata e Kombeve të Bashkuara:

- përkufizimet për sa u përket statistikave të banesave dhe ndërtimit për vendet e rajonit KEE/ të OKB-së (1994)¹; dhe

- rekomandimet për regjistrimet e popullsisë

¹ Standarde Statistikore dhe Studime, nr. 43, United Nations, New York, 1994.



dhe banesave të viteve 1990 në rajonin² KEE.

2. Krahasuar me strukturën e KQP-së versioni i “Ndërtesave” në Klasifikimin e Llojeve të Ndërtimit (KN) është ndarë nivel më të detajuar dhe përfshin një numër të konsiderueshëm treguesish shtesë.

3. KN-ja është hartuar për t’i shërbyer qëllimeve të ndryshme si statistikat mbi aktivitetin e ndërtimit, raporte ndërtimi, regjistrimet e popullsisë dhe banesave, statistikat e çmimeve mbi punimet në ndërtim dhe llogarive kombëtare. Krahas kësaj, KN-ja mund të përdoret për definicionet e ndërtimeve të cilat do të nevojiten si informacion kryesor për variabla specifike si (lejet e ndërtimit, prodhimi në ndërtim) referuar treguesve afatshkurtër. Gjithashtu, KN është hartuar për t’u përdorur për të gjithë procesin jetësor të një ndërtimi: ndryshimet gjatë përdorimit, rikonstruksionet, shkatërrimi. Së fundmi, KN-ja mund të përdoret si klasifikim standard në prokurimin e tenderave të punëve publike të inicuar nga Komisioni.

4. Klasifikimi përdor një sistem dhjetor dhe përfshin:

2 seksione (1-shifror);

6 divizione (2-shifror);

20 grupe (3-shifror);

46 klasa (4-shifror).

5. Ky publikim përbëhet nga tri pjesë:

Pjesa I. Hyrje;

Pjesa II. Struktura;

Pjesa III. Shënime shpjeguese.

Parimet e klasifikimit

6. Në këtë klasifikim, ndërtimet ndahen në dy kategori “Ndërtesa” dhe “Punime inxhinierike”. Në kuadër të këtyre seksioneve KN dallon në radhë të pare duke u bazuar në projektin teknik dhe përdorimin e veçantë të strukturës (p.sh.: ndërtesa tregtare, strukturat e rrugëve, sisteme të furnizimit me ujë, tubacione) dhe, në veçanti, për ndërtesat, duke u bazuar në qëllimin kryesor të përdorimit të tyre (rezidenciale, jorezidenciale).

Vendi ku do të ndërtohet, pronësia dhe institucioni të cilit janë kritere të parëndësishme për këtë klasifikim dhe nuk janë marrë në konsideratë, përjashtojnë rast të veçantë.

7. Punimet inxhinierike janë klasifikuar duke u

bazuar në projektet teknike inxhinierike, të cilat përcaktojnë qëllimin e strukturës së ndërtimit.

Përkufizime

8. *Ndërtimet* janë struktura të lidhura me tokën të bëra me materiale ndërtimi dhe elementë të tjerë të nevojshëm për të ndërtimin e tyre. Në këtë kuadër, përgatitja e tokës, mbjellja etj., për qëllime bujqësore nuk klasifikohen si ndërtime.

9. *Ndërtesat* janë struktura të mbuluara të cilat mund të përdoren të ndara, të ndërtuara për qëllime të përhershme, të përshtatshme për mbrojtjen e njerëzve, kafshëve ose objekteve.

Ndërtesat jo domosdoshmërisht duhet të kenë mure. Është e mjaftueshme që ato të jenë të mbuluara, por duhet të ketë një ndarje e cila dallon qëllimin e veçantë të përdorimit të tyre.

Një ndërtesë e veçuar është çdo lloj ndërtesë e cila nuk është e ngjitur, nuk kufizohet me ndonjë strukturë tjetër; gjithashtu, në rastet e strukturave të ndërlidhura (p.sh.: ndërtesë e lidhur vetëm nga një krah ose shtëpi të veçuar pjesë të një ambient të përbashkët), secila njësi e ndarë nga njësitë e tjera nga një mur zjarri nga dysHEMEJA në çati do të konsiderohet si një ndërtesë individuale.

Për arsye teknike, ndërtesat, gjithashtu, përfshijnë një ndarje të veçantë përdorimi të ndërtimeve nëntokësore të cilat mund të shfrytëzohen nga individët dhe janë të përshtatshme për të siguruar mbrojtjen e tyre, të kafshëve ose objekteve. (p.sh.: streha nëntokësore, spitale nëntokësore, dyqane nëntokësore, garazhe nëntokësore).

Ndërtesat janë ndarë në ndërtesa rezidenciale dhe në ndërtesa jorezidenciale.

10. *Ndërtesat rezidenciale* janë ndërtime ku të paktën gjysma e sipërfaqes së objektit do të shfrytëzohet për qëllime banimi. Në rast se më pak se gjysma e sipërfaqes së objektit do të shfrytëzohet për qëllime banimi; ndërtesa duhet të klasifikohet në kategorinë e ndërtesave jorezidenciale duke u bazuar në qëllimin e projektit të hartuar.

11. *Ndërtesat jorezidenciale* janë ndërtime ku të paktën gjysma e sipërfaqes së objektit do të shfrytëzohet për qëllime të ndryshme nga ato të banimit. Në rast se të paktën gjysma e sipërfaqes së do të shfrytëzohet për qëllime banimi, ndërtesa duhet klasifikuar si ndërtesë rezidenciale.

² Standarde Statistike dhe Studime, nr. 40, United Nations, New York, 1987.



12. Sipërfaqja e shfrytëzueshme gjithsej nuk përfshin:

- zonat e ndërtimit (zonat ndarëse, kolonat, shtyllat, akset, oxhaqet);

- zonat funksionale për përdorimet ndihmëse (zonat e zëna për instalime të ajrit të kondicionuar, gjeneratorët);

- rrugëkalimet (sipërfaqet e përbashkëta, ashensorët, shkallët lëvizëse).

Pjesa e sipërfaqes së shfrytëzueshme gjithsej të një ndërtese për qëllime rezidenciale përfshin zonat për gatim, dhomat e ndenjes dhe ato të gjumit, bodrumet, dhe dhomat e tjera të përbashkëta të përdorura nga pronarët e njësisë së banimit.

13. *Punimet inxhinierike* janë të gjitha llojet e ndërtimit të cilat nuk klasifikohen si ndërtesa: hekurudha, rrugë, ura, autostrada, pistat e fushës së aviacionit, diga etj.

Udhëzime për klasifikimin e ndërtimeve

14. Njësia e cila do të përdoret për klasifikimin, në përgjithësi është ndërtimi individual (ndërtesa, rrugë, tubacione etj.). Në raste specifike është e mundur për ta aplikuar atë vetëm si një prone e tërë.

15. Për ndërtimet komplekse të përbëra, për shembull, nga një grup ndërtesash, secila ndërtesë duhet të klasifikohet si një njësi e veçantë. Në rast se, për shembull, një shkollë përbëhet nga një ndërtesë shkollë dhe nga një hostel, ndërtesa e shkollës duhet të klasifikohet te 1263, ndërsa hosteli i përket 1130. Megjithatë, siç u përmend më lart, nëse nuk kemi të dhëna të detajuara, kompleksi duhet të klasifikohet te 1263.

16. Siç u përmend më parë, ndërtimet klasifikohen duke u bazuar te përdorimi i veçantë i tyre. Ndërtimet e përdorura ose projektuar për disa qëllime (p.sh.: një rezidencë e kombinuar, hotel dhe ndërtesë zyrash) duhet t'i caktohen një klasifikimi të vetëm, duke u bazuar te përdorimi kryesor i tyre. Përdorimi kryesor duhet të përcaktohet si më poshtë:

- Qëllimet e ndryshme të ndërtimit me sipërfaqen e shfrytëzueshme të veçantë gjithsej të tyre, duhet të llogariten, sipas qëllimit/përdorimit të ndarë dhe bazuar në klasifikim.

- Atëherë ndërtimi klasifikohet sipas metodës “lart–poshtë”: ndërtimit në fillim i caktohet seksioni 1-shifror (ndërtesa ose punime inxhinierike), e cila mbulon pjesën më të madhe të sipërfaqes gjithsej; pastaj, duhet t'i caktohet seksionit 2-shifror (ndërtesa rezidenciale, ndërtesa jorezidenciale, infrastruktura e transportit etj.) me pjesën më të madhe në seksion. Në rastin pasardhës duhet t'i caktohet grupit 3-shifror me pjesën më të madhe në divizion. Në fund të klasës 4-shifrore me pjesën më të madhe të sipërfaqes gjithsej në grup.

17. Ky rregull mund të ilustruhet në bazë të shembullit teorik të mëposhtëm:

Sipërfaqja e shfrytëzueshme gjithsej e një ndërtese ndahet në:

Lloji i përdorimit	Përqindja e sipërfaqes së shfrytëzueshme gjithsej	KN Klasa
<i>Banesë me 4 kate</i>	30%	1122
<i>Zyra të njësisë kredituese</i>	10%	1220
<i>Farmaci dhe dyqane</i>	20%	1230
<i>Librari</i>	30%	1262
<i>Institucione të kujdesit shëndetësor</i>	10%	1264

Në këto raste ndërtesa klasifikohet si më poshtë:

- në divizionin 2-shifror 12 “Ndërtesat jorezidenciale”, sepse kjo mbulon përqindjen më të madhe (70%);

- në grupin 3-shifror 126 “Ndërtesat për argëtim publik, edukim ose spitale dhe institucione të kujdesit shëndetësor”, sepse kjo mbulon përqindjen më të madhe (40%) në divizionin 12;

- së fundmi në klasën 4-shifrore 1262 “Muzeume dhe librari”, sepse kjo mbulon përqindjen më të madhe (30%) në njësinë e grupit 126.



PJESA II
STRUKTURA

1.	NDËRTESTESA	KQP referencë
11	Ndërtesa rezidenciale (ndërtesa banimi)	
111	Banesa me një kat	
1110	Banesa me një kat	52 111.p1
112	Banesa me dy ose më shumë kate	
1121	Banesa me dy kate	52 111.p2
1122	Banesa me tri ose më shumë kate	52 119.p1
113	Rezidenca për komunitetet	
1130	Rezidenca për komunitetet	52 119.p2
12	Ndërtesa jorezidenciale	
121	Hotele dhe ndërtesa të ngjashme	
1211	Ndërtesa për hotele	52 124.p1
1212	Ndërtesa të tjera për akomodim afatshkurtër	52 124.p2
122	Ndërtesa për zyra	
1220	Ndërtesa për zyra	52 122.p1
123	Ndërtesa për tregti me shumicë e pakicë	
1230	Ndërtesa për tregti me shumicë e pakicë	52 122.p2
124	Ndërtesa trafiku dhe komunikacioni	
1241	Ndërtesa komunikacioni, stacione, terminale dhe ndërtesa të lidhura	52 122.p3
1242	Ndërtesa për garazhe	52 122.p4
125	Ndërtesa industriale dhe depo	
1251	Ndërtesa industriale	52 121.p1
1252	Depozita, kapanone dhe depo	52 121.p2
126	Argëtim publik, edukim, spitale ose institucione të tjera kujdesi	
1261	Ndërtesa për argëtim publik	52 123
1262	Muzeume dhe librari	52 125.p1
1263	Shkolla, universitete dhe ndërtesa kërkimore	52 125.p2
1264	Spitale ose ndërtesa për institucione kujdesi	52 126
1265	Salla Sporti	52 279.p1
127	Ndërtesa të tjera jorezidenciale	
1271	Ndërtesa bujqësore (ferma) jorezidenciale	52 129.p1
1272	Ndërtesa të përdorura si vende të shenjta dhe për aktivitete fetare	52 129.p2
1273	Monumente historike ose të mbrojtura	52 129.p3
1274	Ndërtesa të tjera të paklasifikuara	52 129.p4
2.	PUNIME INXHINIERIKE	KQP referencë
21	Infrastruktura e transportit	
211	Autostrada, rrugë urbane dhe interurbane	
2111	Autostrada	52 211.p1
2112	Rrugë urbane dhe interurbane	52 211.p2
212	Hekurudha	
2121	Hekurudha të distancave të gjata	52 212.p1
2122	Hekurudha urbane	52 212.p2
213	Pistat e fushës së aviacionit	
2130	Pistat e fushës së aviacionit	52 213
214	Ura, mbikalime të larta, tunele dhe metro	
2141	Ura dhe mbikalime të larta	52 221 + 52 222
2142	Tunele dhe metro	52 223 + 52 224



215	Porte, kanale të lundrueshme, diga dhe sisteme të tjera të furnizimit me ujë	
2151	Porte dhe kanale të lundrueshëm	52 232
2152	Diga	52 233
2153	Ujësjiellës, sisteme furnizimi me ujë për ujtitje dhe kultivim	52 231 + 52 234
22	Linja tubacionesh, telekomunikacioni dhe elektrike	
221	Tubacione të linjave të gjata, telekomunikacioni dhe elektrike	
2211	Tubacione gazi dhe vaji të linjave të gjata	52 241.p2
2212	Tubacione uji të linjave të gjata	52 241.p1
2213	Tubacione telekomunikacioni të linjave të gjata	52 242
2214	Tubacione elektrike të linjave të gjata	52 243
222	Tubacione dhe kablo vendorë	
2221	Linja vendore të furnizimit me gaz	52 250.p1
2222	Linja vendore të furnizimit me ujë	52 250.p2
2223	Linja vendore të ujërave të zeza	52 250.p3
2224	Linja vendore elektrike dhe kablo telekomunikacioni	52 250.p4
23	Ndërtime komplekse në kantieret industriale	
230	Ndërtime komplekse në kantieret industriale	
2301	Punime ndërtimi për gjurmime dhe nxjerrje	52 261
2302	Ndërtime në centralet elektrike	52 262
2303	Ndërtime në fabrikat kimike	52 263
2304	Fabrika të industrisë së rëndë, të paklasifikuara në vend tjetër	52 269
24	Punime të tjera inxhinierike	
241	Ndërtime sporti dhe rekreacioni	
2411	Terrene sportive	52 271
2412	Ndërtime të tjera sportive dhe rekreacioni	52 279.p2
242	Punime të tjera inxhinierike të paklasifikuara në vend tjetër	
2420	Punime të tjera inxhinierike të paklasifikuara në vend tjetër	52 290

Pjesa III

Shënime shpjeguese

1	NDËRTESA
----------	-----------------

11	Ndërtesa rezidenciale (ndërtesa banimi)
111	1110 Ndërtesa banimi me një kat
	Kjo klasë përfshin:
	- Shtëpitë e veçuara njëkatëshe, si: vilat, shtëpitë e drurit, shtëpitë në pyje, në ferma, në fshat, shtëpitë verore dhe ato të pushimit etj.
	Kjo klasë, gjithashtu, përfshin:
	- Shtëpitë e veçuara në ambient të përbashkët, ku secila banesë ka çatinë e saj dhe një hyrje direkte nga sipërfaqja e tokës
	<i>Kjo klasë nuk përfshin:</i>
	<i>- ndërtesat jorezidenciale fermere 1271</i>
112	Ndërtesa banimi me dy ose më shumë kate
1121	Ndërtesa banimi me dy kate
	Kjo klasë përfshin:
	- shtëpitë e veçuara ose gjysmë të veçuara me dy kate
	<i>Kjo klasë nuk përfshin:</i>
	- shtëpitë e veçuara ose shtëpitë e veçuara në ambient të përbashkët, ku secila banesë ka çatinë e saj dhe një hyrje direkte nga sipërfaqja e tokës 1110
1122	Ndërtesa banimi me tri ose më shumë kate
	Kjo klasë përfshin:
	- ndërtesa të tjera rezidenciale si pallate, blloqe pallatesh, apartamente banimi me tri ose më shumë kate
	<i>Kjo klasë përfshin:</i>
	<i>- rezidencat për komunitetet 1130</i>



- hotelet 1211
- hotelet për të rinj, kampet e pushimit dhe shtëpitë verore 1212
- 113 1130 **Rezidencat për komunitetet**
Kjo klasë përfshin:
- ndërtesat rezidenciale për komunitetet, ku përfshihen rezidencat dhe qendrat e shërbimit për fëmijë, studentë dhe grupe të tjera sociale, azilet, hotelet për punonjësit, hotelet për të pastrehët, jetimore etj.
Kjo klasë nuk përfshin:
- spitalet dhe klinikat 1264
- ndërtesa institucionale me shërbim mjekësor 1264
- burgjet, kazermat 1274
- 12 121 **Ndërtesa jorezidenciale**
1211 **Hotele dhe ndërtesa të ngjashme**
Hotele
Kjo klasë përfshin:
- hotele, motele, pensione dhe ndërtesa të tjera të ngjashme, me ose pa restorant
Kjo klasë, gjithashtu, përfshin:
- restorantet dhe baret
Kjo klasë nuk përfshin:
- restorantet në ndërtesa apartamentesh 1122
- hotelet për të rinj, strehët malore, kampet e pushimit 1212
- restorantet në qendrat tregtare 1230
- 1212 **Ndërtesa të tjera akomodimi afatshkurtër**
Kjo klasë përfshin:
- hotelet për të rinj, strehët malore, kampet e pushimit për fëmijë ose familje, shtëpi të tjera pushimi të paklasifikuara në vend tjetër
Kjo klasë nuk përfshin:
- hotelet dhe ndërtesa të ngjashme 1211
- parqet për argëtim në kohën e lirë 2412
- 122 1220 **Ndërtesa për zyra**
Kjo klasë përfshin:
- ndërtesa të përdorura si vende biznesi, për qëllime administrative, banka, zyra postare, zyra bashkiake, zyra qeveritare etj.
Kjo klasë, gjithashtu, përfshin:
- salla konferencash dhe kongresesh, salla gjyqësore, godina parlamentare
Kjo klasë nuk përfshin:
- zyra në ndërtesa të përdorura më së shumti për qëllime të tjera
- 123 1230 **Ndërtesa tregtie me shumicë dhe pakicë**
Kjo klasë përfshin:
- qendrat tregtare, dyqanet, butikët, marketet në ambiente të brendshme, sallat e përdorura për panairë, ekspozita, ankande, stacionet e shërbimit etj.
Kjo klasë nuk përfshin:
- dyqanet në ndërtesa të përdorura më së shumti për qëllime të tjera
- 124 1241 **Ndërtesa trafiku dhe komunikacioni**
Ndërtesa komunikacioni, stacione, terminale dhe ndërtesa të lidhura
Kjo klasë përfshin:
- ndërtime dhe instalime të aeroporteve civile dhe ushtarake, stacione hekurudhore, stacione autobusi dhe porte për ankorim, stacione makinash elektrike dhe teleferiku
- ndërtesa radioje dhe televizioni, ndërtesat me antena për sinjal telefonik, qendra telekomunikacioni etj.
Kjo klasë, gjithashtu, përfshin:
- hangarët e aeroplanëve, godina të kontrollit hekurudhor etj.
- kabinat e telefonit
- kullat e ndriçimit
- kullat e kontrollit të trafikut ajror
Kjo klasë nuk përfshin:
- stacione shërbimi 1230
- depoza rezervimi, kapanone dhe depo 1252
- linjat hekurudhore 212
- pistat e avionëve 2130
- linja dhe antena telekomunikacioni 2213, 2224
- terminale të hidrokarbureve 2303
- 1242 **Ndërtesa për garazhe**



- Kjo klasë përfshin:
- garazhe (tokësore dhe nën tokësore) dhe parkime të mbuluara të automjeteve
- Kjo klasë, gjithashtu, përfshin:
- parkingje dhe strehë për biçikleta
- Kjo klasë nuk përfshin:*
- vendparkime automjeteve në ndërtesa të përdorura më së shumti për qëllime të tjera
- stacione shërbimi 1230
- 125 Ndërtesa industriale dhe depo**
- 1251 Ndërtesa industriale**
- Kjo klasë përfshin:
- ndërtesa të mbuluara të përdorura për prodhim industrial, fabrika, thertore, kantina, fabrika prodhimi automjeteve etj.
- Kjo klasë nuk përfshin:*
- depozita rezervimi, kabanone, depo 1252
- ndërtesa jorezidenciale fermash 1271
- instalime komplekse industriale (nënstacione energjie, rafineri etj.) të cilat nuk kanë karakteristikat e një ndërtese 230
- 1252 Depozita, kabanone dhe depo**
- Kjo klasë përfshin:
- depozita dhe cisterna
- depozita për vaj dhe gaz
- kabanone për drithëra, çimento ose grupime të tjera të thata
- frigoriferë dhe depo të tjera të specializuara
- Kjo klasë, gjithashtu, përfshin:
- zona magazinimi
- Kjo klasë nuk përfshin:*
- kabanone bujqësore dhe ndërtesa magazinimi për produkte bujqësore 1271
- cisterna të mëdha uji për furnizim 2222
- terminale hidrokarboni 2303
- 126 Argëtim publik, edukim, spitale ose institucione të tjera kujdesi**
- 1261 Ndërtesa argëtimi publik**
- Kjo klasë përfshin:
- kinematë, sallat e koncerteve, salla operash, teatro etj.
- salla mbledhjesh dhe salla multifunkionale të përdorura më së shumti për argëtim publik
- kazinotë, cirqet, salla muzike, salla kërcimi dhe diskoteka etj.
- Kjo klasë nuk përfshin:*
- muzeumet, galeritë e artit 1262
- salla sporti 1265
- parqet për argëtim në kohën e lirë 2412
- 1262 Muzeume dhe librari**
- Kjo klasë përfshin:
- muzeume, galeritë e artit, libraritë dhe qendrat kërkimore
- Kjo klasë, gjithashtu, përfshin:
- ndërtesat e arkivave
- Kjo klasë nuk përfshin:*
- monumentet historike 1273
- 1263 Shkolla, universitete dhe ndërtesa të përdorura për qëllime kërkimore**
- Kjo klasë përfshin:
- ndërtesa të përdorura për edukim parashkollor, nëntëvjeçar dhe të mesëm (shkolla infermierie, shkolla teknike, shkolla gjuhe, shkolla sportive, shkolla artistike, kolegje etj.); shkolla të formimit profesional; shkolla të tjera.
- ndërtesa të përdorura për arsim të lartë (përfshi të gjithë llojet e arsimit të lartë) dhe qëllime kërkimore shkencore; laboratorë kërkimorë.
- Kjo klasë, gjithashtu, përfshin:
- shkolla speciale për fëmijë me aftësi të kufizuara
- kolegje për arsimim të mëtejshëm
- stacione të parashikimit të motit, kulla vëzhgimi
- Kjo klasë nuk përfshin:*
- konviktet shkollorë 1130
- hostelet për studentë 1130
- libraritë 1262
- spitalet universitare 1264
- 1264 Spitale ose ndërtesa të tjera kujdesi**



- Kjo klasë përfshin:
- institucione të cilat ofrojnë shërbim mjekësor për persona të sëmurë ose të plagosur
 - sanatorime, spitale të qëndrimit afatgjatë, spitale psikiatrike, dispanseritë, maternitete etj.
- Kjo klasë, gjithashtu, përfshin:
- spitale universitare, spitale burgjesh ose të forcave të armatosura
 - ndërtesa të përdorura për kurim termal, terapi me ujë deti, funksione rehabilitimi, transfuzion gjaku, mbledhje të qumështit të gjirit, trajtim veterinarie etj.
 - ndërtesa institucionale me shërbime rezidenciale, infermierie ose kujdesi mjekësor për të moshuarit, njerëzit me aftësi të kufizuara etj.
- Kjo klasë nuk përfshin:*
- *rezidencat ose banesat me asistencë sociale për të moshuarit ose njerëzit me aftësi të kufizuara etj. 1130*
- 1265 Sallat e sportit**
- Kjo klasë përfshin:
- ndërtesa të përdorura për sporte në salla të mbyllura (basketboll dhe fusha tenisi, pishina, salla gjimnastike, pista skish, fusha të hokejit në akull etj.) të cilat mundësojnë lehtësira për spektatorët (vende për t'u ulur) dhe për pjesëmarrësit (dushë dhe dhoma zhveshje etj.)
- Kjo klasë nuk përfshin:*
- *salla multifunksionale të cilat përdoren kryesisht me qëllim argëtimin publik 1261*
 - *terrene sportive të përdorura për sporte ajrore, fusha të hapura tenisi, pishina të pambuluara etj. 2411*
- 127 Ndërtesa të tjera jorezidenciale**
- 1271 Ndërtesa bujqësore jorezidenciale**
- Kjo klasë përfshin:
- ndërtesa fermash dhe ndërtesa magazinimi të përdorura për bujqësi, stalla lopësh, ahure, stalla derrash, vathë kopesh, kolibe, kotece industriale, hambarë, hangarë dhe ndërtesa bujqësore, qilarët, qilarë verërash, serat, kabanone bujqësore etj.
- Kjo klasë nuk përfshin:*
- *kopshtet botanike dhe zoologjike 2412*
- 1272 Ndërtesa të përdorura si vende të shenjta dhe për aktivitete fetare**
- Kjo klasë përfshin:
- kishat, teqetë, xhamitë, sinagogat etj.
- Kjo klasë, gjithashtu, përfshin:
- varrezat, sallonet e homazheve, krematoriumet
- Kjo klasë nuk përfshin:*
- *ndërtesat fetare të përdorura si muze 1262*
 - *monumentet historike etj. 1273*
- 1273 Monumente historike ose të mbrojtura**
- Kjo klasë përfshin:
- monumentet historike ose të mbrojtura, të çdo lloji, të cilat nuk përdoren për qëllime të tjera
- Kjo klasë, gjithashtu, përfshin:
- rrënojat e mbrojtura, gërmimet arkeologjike dhe faqet prehistorike
 - statujat dhe përkujtimoret, ndërtimet artistike ose dekorative
- Kjo klasë nuk përfshin:*
- *muzeumet 1262*
 - *ndërtesat fetare 1272*
- 1274 Ndërtesa të tjera të paklasifikuara në vend tjetër**
- Kjo klasë përfshin:
- qendrat e riedukimit, burgjet dhe qendrat e paraburgimit, kazernat për forcat e armatosura, godina shërbimi policie dhe zjarfikëseje
- Kjo klasë, gjithashtu, përfshin:
- struktura si stacionet e autobusëve, tualetet publike, lavanderitë etj.
- Kjo klasë nuk përfshin:*
- *kabinat telefonike 1241*
 - *spitalet e qendrave të riedukimit, burgjeve dhe forcave të armatosura 1264*
 - *punimet inxhinierike ushtarake 2420*



- Kjo klasë, gjithashtu, përfshin:
- instalimet për ndriçim, sinjalistikë, siguri rrugore dhe parkingje
Kjo klasë nuk përfshin:
- stacionet e shërbimit në autostrada, (autogrillat) 1230
- urat dhe autostradat në nivel të lartë 2141
- tunelet dhe metrotë 2142
- 2112 Rrugë urbane dhe interurbane**
Kjo klasë përfshin:
- rrugët në brendësi të qyteteve dhe fshatrave, rrugët nëpër pyje (parkingjet e hapura, mbikalimet, degëzimet, rrethrotullimet etj.) rrugët, sheshet, rrugicat, korsitë, rrugët e pa shtruara, rrugë lidhëse, rrugë fermash, trotuare, korsi biçikletash etj.
Kjo klasë, gjithashtu, përfshin:
- instalimet për ndriçim, sinjalistikë, siguri rrugore dhe parkingje
- 212 Linjat hekurudhuore**
- 2121 Hekurudhat e distancave të gjata**
Kjo klasë përfshin:
- linjat kryesore hekurudhore, binarët, kalimet e trenave, linjat e ndarjeve të trenave etj.
Kjo klasë, gjithashtu, përfshin:
- instalimet për ndriçim, sinjalistikë, siguri dhe elektrifikim
Kjo klasë nuk përfshin:
- stacionet hekurudhore 1241
- urat hekurudhore 2141
- tunelet hekurudhore 2142
- 2122 Hekurudha urbane**
Kjo klasë përfshin:
- hekurudhat metropolitane, nëntokësore; linjat hekurudhore të varura ose në lartësi të mëdha; linjat urbane, të ndara nga llojet e tjera të trafikut, tramvajet etj.
Kjo klasë, gjithashtu, përfshin:
- instalimet për ndriçim, sinjalistikë, siguri dhe elektrifikim
- 213 2130 Pistat e fushës së aviacionit**
Kjo klasë përfshin:
- pista për ulje-ngritje
Kjo klasë, gjithashtu, përfshin:
- instalimet për ndriçim, sinjalistikë dhe siguri
- 214 2141 Ura, mbikalime të larta, tunele dhe metro**
2141 Ura dhe mbikalime të larta
Kjo klasë përfshin:
- rrugë ose ura hekurudhore prej metali, betoni ose materiale të tjera, përfshi strukturat për mbikalime të larta
Kjo klasë, gjithashtu, përfshin:
- instalimet për ndriçim, sinjalistikë dhe siguri
- ura të lëvizshme, rruga-urat, urat në ferma e pyje dhe urat për këmbësorë
- 2142 Tunele dhe metro**
Kjo klasë përfshin:
- autostradat, rrugë dhe tunele hekurudhore, metrotë
Kjo klasë, gjithashtu, përfshin:
- instalimet për ndriçim, sinjalistikë dhe siguri
- 215 2151 Porte, kanale të lundrueshëm, diga dhe sisteme të tjera të furnizimit me ujë**
2151 Porte dhe kanale të lundrueshëm
Kjo klasë përfshin:
- porte detare ose lumenjsh (mole, vende për të ankoruar mjetin etj.)
- kanale të lundrueshëm
- punime në lumenj dhe ndërtimet e kanaleve (ura kanalesh dhe tunele), skela dhe argjinatura
Kjo klasë, gjithashtu, përfshin:
- porte ushtarake
- kantieret detare
Kjo klasë nuk përfshin:
- fare 1241
- digat dhe ndërtime të tjera ujë mbajtëse 2152
- terminallet bregdetare dhe lumore të hidrokarbureve 2303
- marinat e mjeteve të vogla lundruese 2412



- 2152 Diga**
 Kjo klasë përfshin:
 - digat dhe ndërtime të tjera ujë mbajtëse të ngjashme për çfarë do lloj qëllimi: hidro-elektrike, ujitje, rregullim rrjedhash, parandalime përmytjesh
 Kjo klasë, gjithashtu, përfshin:
 - pritrat, struktura mbrojtëse të brigjeve
Kjo klasë nuk përfshin:
 - stacione të energjisë hidroelektrike 2302
- 2153 Ujësjiellës, sisteme furnizimi me ujë për ujitje dhe kultivim**
 Kjo klasë përfshin:
 - kanalet ujtëse dhe ndërtime të tjera të furnizimit me ujë për qëllime të kultivimit të tokës
 - ujësjiellësit
 Kjo klasë, gjithashtu, përfshin:
 - punimet për vepra kulluese dhe kanalet kulluese
Kjo klasë nuk përfshin:
 - ujësjiellësit si monumente historike 1273
 - diga 2152
 - tubacionet e ujit 2212, 2222
- 22 Linja tubacionesh, telekomunikacioni dhe elektrike**
- 221 Tubacione të linjave të gjata, telekomunikacioni dhe elektrike**
- 2211 Tubacionet e linjave të gjata të gazit dhe ujit**
 Kjo klasë përfshin:
 - linja të gjata me rrugë tokësore, nëntokësore ose tubacione nënujore për transportimin e naftës dhe nënprodukteve të saj dhe gazit
 - linja të gjata me rrugë tokësore, nëntokësore ose tubacione nënujore për produkte kimike dhe të tjera
 Kjo klasë, gjithashtu, përfshin:
 - stacionet e pompimit
Kjo klasë nuk përfshin:
 - tubacionet e ujit 2212, 2222
 - linjat urbane të furnizimit me gaz 2221
 - terminallet e hidrokarbureve 2303
- 2212 Tubacione uji të linjave të gjata**
 Kjo klasë përfshin:
 - linja të gjata me rrugë tokësore, nëntokësore ose tubacione nënujore për transportimin e ujit
 Kjo klasë, gjithashtu, përfshin:
 - stacionet ujëmbledhëse, filtruese dhe pompuese
Kjo klasë nuk përfshin:
 - kanalet kulluese dhe ujësjiellësit 2153
 - tubacionet vendore për furnizimin me ujë 2222
- 2213 Linja telekomunikacioni të distancave të gjata**
 Kjo klasë përfshin:
 - linja të gjata me rrugë tokësore, nëntokësore ose linja nënujore telekomunikacioni, sisteme transmetimi, rrjete radioje ose televizioni, kulla transmetimi, infrastrukture komunikimi të radiove etj.
Kjo klasë nuk përfshin:
 - linjat elektrike 2214
 - rrjetet urbane të telekomunikacionit 2224
- 2214 Linja elektrike të distancave të gjata**
 Kjo klasë përfshin:
 - linja të gjata me rrugë tokësore ose linja nëntokësore të shpërndarjes elektrike të tensionit të mesëm ose të lartë
 Kjo klasë përfshin:
 - stacione, nënstacione dhe shtylla transmetimi
Kjo klasë nuk përfshin:
 - instalimet për ndriçimin e rrugëve 2111, 2112
 - linjat urbane të shpërndarjes së fuqisë elektrike dhe instalimet ndihmuese 2224
- 222 Tubacione dhe kabllorë vendorë**
- 2221 Linjat vendore të furnizimit me gaz**
 Kjo klasë përfshin:
 - tubacionet vendore tokësore ose nëntokësore për transportimin e gazit
- 2222 Linjat vendore të furnizimit me ujë**
 Kjo klasë, gjithashtu, përfshin:
 - tubacionet vendore për transportimin e ujit të nxehtë, avullit ose ajrit të kompresuar



- kullat e ujit, puset, tubacione uji të veçanta etj.
Kjo klasë nuk përfshin:
 - sistemet e njihtës 2153
 - sisteme të pastrimit të ujit 2223
- 2223 Tubacione vendore të ujërave të zeza**
 Kjo klasë përfshin:
 - rrjetet e kanalizimit dhe kolektorët e ujërave të zeza
 Kjo klasë, gjithashtu, përfshin:
 - impiante të trajtimit të ujërave të zeza
- 2224 Kabllot vendorë të elektricitetit dhe telekomunikacionit**
 Kjo klasë përfshin:
 - kabllot vendorë të elektricitetit dhe të telekomunikacionit (tokësore ose nëntokësore) dhe sisteme ndihmuese (stacionet dhe nënstacionet, shtyllat telegrafike etj.)
 Kjo klasë, gjithashtu, përfshin:
 - kabllot të televizioneve vendore dhe antenat e përbashkëta
- 23 230 Ndërtime komplekse në kantieret industriale**
 Ky seksion përfshin ndërtimet komplekse industriale (stacione të prodhimit të energjisë, rafineritë etj.) të cilat nuk kanë karakteristikat e një ndërtese
- 2301 Punime ndërtimi për gjermime dhe nxjerrje**
 Kjo klasë përfshin:
 - punime dhe ndërtime në miniera, nxjerrjen e hidrokarbureve, gurorët, shfrytëzimin e gropave të zhavorrit etj.
 - punime suvaje, çimentoje, tullash, tjegullash etj.
- 2302 Punime në centralet elektrike**
 Kjo klasë përfshin:
 - stacione të energjisë termike ose hidraulike dhe pajisjet për gjenerimin e energjisë elektrike, p.sh. stacione qymyrguri, stacione të fuqisë nukleare, stacione të energjisë së erës
 Kjo klasë, gjithashtu, përfshin:
 - impiante për trajtimin dhe përpunimin e materialeve nukleare
 - furra e djegies (inceneratorë) të mbetjeve;
Kjo klasë nuk përfshin:
 - digjat 2152
 - linjat elektrike, përfshirë stacionet dhe nënstacionet 2214
- 2303 Fabrikat kimike**
 Kjo klasë përfshin:
 - punimet me përbërje kimike, fabrikat ose rafineritë petrokimike
 Kjo klasë, gjithashtu, përfshin:
 - terminalët e hidrokarbureve
 - fabrika të produkteve me përmbajtje të lartë karboni, uzina gazi
- 2304 Fabrikat e industrisë së rëndë, të paklasifikuara në vend tjetër**
 Kjo klasë përfshin:
 - punimet e industrisë së rëndë si furrat e shkrirjes, fabrika metalore, uzina shkrirje metalore etj.
- 24 241 Punime të tjera inxhinierike**
Ndërtime sporti dhe rekreacioni
- 2411 Terrenet sportive**
 Kjo klasë përfshin:
 - terrenet për sporte të luajtura më së shumti në ambiente të hapura si futboli, bejsbolli, regbija, sportet detare, pistat për gara me makina, biçikleta dhe kuaj
Kjo klasë nuk përfshin:
 - salla sportive për sporte të luajtura në ambiente të brendshme 1265
 - kënde lojërash, parqet për argëtim në kohën e lirë 2412
 - kurse golfi 2412
 - instalime portuale për marinën 2412
- 2412 Ndërtime të tjera sportive dhe rekreacioni**
 Kjo klasë përfshin:
 - parqet për argëtim në kohën e lirë dhe ndërtime të tjera në ajër të hapur përfshirë (pistat e skive, teleferikët etj.), fusha golfi, qendra hipizmi, instalime në porte të cilat do të përdoren kryesisht për sporte ujore, pajisje për plazhe.
 Kjo klasë, gjithashtu, përfshin:
 - kopshtet dhe parqet publike, kopshtet botanike dhe zoologjike
Kjo klasë nuk përfshin:
 - strehët malore 1212



- stacione makinash elektrike dhe teleferiku 1241
- ndërtesa për argëtim publik 1261
- ndërtesa të kopshëve zoologjike dhe botanike 1261
- sallone sporti 1265

242 2420 Punime të tjera inxhinierike të paklasifikuara në vend tjetër

Kjo klasë përfshin:

- punime inxhinierike ushtarake, p.sh. fortesa, bunkerët, poligone qitjeje, qendrat e testimeve ushtarake etj.

- punime të tjera inxhinierike të paklasifikuara në vend tjetër, përfshirë qendrat për lëshime hapësinore

Kjo klasë, gjithashtu, përfshin:

- ndërtime industriale ose urbane të braktisura

- magazinimi i mbetjeve;

Kjo klasë nuk përfshin:

- ndërtesa aeroportuale 1241

- kazermat 1274

- portet ushtarake 2151

VENDIM

Nr. 137, datë 20.3.2019

**PËR MIRATIMIN E
NOMENKLATURËS SË STATISTIKAVE
TË TRANSPORTIT, NST–2007**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, dhe të pikës 5, të nenit 24, të ligjit nr. 17/2018, “Për statistikën zyrtare”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e zbatimit të nomenklaturës së statistikave të transportit, NST–2007, të miratuar paraprakisht nga Komisioni Kombëtar për Nomenklaturën, sipas lidhjes 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Nomenklatura e statistikave të transportit, NST–2007, zbatohet për mbledhjen, klasifikimin dhe publikimin e të dhënave statistikore zyrtare për konsumin e familjeve.

3. Instituti i Statistikave kryen përditësimin e informacionit statistikor zyrtar duke filluar nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

4. Ngarkohen Instituti i Statistikave, agjencitë statistikore, ministrinë e linjës, dhe institucionet qendrore e vendore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Erion Braçe**

**NOMENKLATURA STANDARDE E TRANSPORTEVE NST
2007
AL**

Niveli i detajimit në sistemin statistikor

Niveli i parë i klasifikimit NST 2007 ka 20 ndarje të cilat do të përdoren për klasifikimin e llojit të mallrave

ANEKS

NOMENKLATURA STANDARDE E TRANSPORTEVE (NST 2007)

Ndarja	Përshkrimi
01	Produktet bujqësore, gjuetisë, pyjeve dhe peshku dhe produktet e tjera të peshkimit
02	Qymyr dhe linjit; naftë bruto dhe gaz natyror
03	Produktet metalike dhe të minierave dhe produkte të tjera të gurorëve; torfe; uranium dhe torium
04	Produkte ushqimore, pijeve dhe duhanit
05	Tekstile dhe produkte tekstili; lëkurë dhe produkte lëkure
06	Druri dhe produktet e drurit dhe produktet me tapë (përveç mobilieve); artikujt prej kashte dhe



	materialeve thurës; pulpë, letër dhe produkte letre; materialet e shtypura dhe mediat e regjistruara
07	Koks dhe produktet e rafinuara të naftës
08	Kimikate, produkte kimike, dhe fibra të bëra nga njeriu; produkte gome dhe plastike, karburant bërthamor
09	Produkte të tjera minerale (jometalike)
10	Metale bazë; produkte metalike të fabrikuara, përveç makinerive dhe pajisjeve
11	Makineri dhe pajisje; pajisje zyre dhe kompjuter; makineri elektrike dhe aparatura si radio, televizion dhe pajisjet e komunikimit; instrumentet mjekësorë dhe orë
12	Pajisje transporti
13	Mobilie; mallra të tjera të përpunuara të p.k.v.
14	Lëndë të para të ricikluara; mbetjet e ngurta (bashkiake) dhe mbeturinat e tjera
15	Pako postare
16	Pajisje dhe materiale që përdoren në transportin e mallrave
17	Mallra të lëvizura në rrugën e zhvendosjes së familjeve dhe zyrave; bagazheve të transportuara të ndara nga ato të udhëtarëve; automjetet të transportuara për riparim; mallra jotregtare të tjera
18	Mallra të grupuara: një përzierje e llojeve të mallrave të cilat janë transportuar së bashku
19	Mallra të paidentifikuara: mallrat që për ndonjë arsye nuk mund të identifikohen dhe për këtë arsye nuk mund të caktohet në grupe 01–16
20	Mallra të tjera të p.k.v.

Nomenklatura e përbashkët në përdorimin për klasifikimin e mallrave të transportuara
Versioni reference = NST 2007 REV 2

Ndarja	Grupi	Përshkrimi	Nomenklatura e produkteve sipas aktiviteteve (CPA2008)
01		Produktet e bujqësisë, gjuetisë, pyjeve Peshku dhe produktet e tjera të peshkimit	
	01.1	Drithëra	01.11.1, 01.11.2, 01.11.3, 01.11.4, 01.12
	01.2	Patate	01.13.51
	01.3	Panxhar sheqeri	01.13.71
	01.4	Fruta të tjera të freskëta dhe perime	01.11.6, 01.11.7, 01.13.1, 01.13.2, 01.13.3, 01.13.4, 01.13.52, 01.13.53, 01.13.59, 01.13.8, 01.13.9, 01.14, 01.21, 01.22, 01.23, 01.24, 01.25.1, 01.25.3, 01.25.9, 01.26, 02.30.4
	01.5	Pemë pyjore, pemë të prera të përshtatshme për qëllime zbukuruese	02.10.1, 02.10.3, 02.2, 02.30.1, 02.30.2, 02.30.3
	01.6	Bimë të gjalla dhe lule	01.13.6, 01.13.72, 01.19.2, 01.25.2, 01.30
	01.7	Lëndë të tjera me origjinë nga perimet	01.11.5, 01.11.8, 01.11.9, 01.15,



			01.16, 01.19.1, 01.19.3, 01.27, 01.28, 01.29
	01.8	Kafshë të gjalla	01.41.1, 01.42.1, 01.43, 01.44, 01.45.1, 01.46, 01.47.1, 01.49.1
	01.9	Qumështi i papërpunuar nga kafshët e qumështit (lope, dele, dhi)	01.41.2, 01.45.2
	01 .A	Produkte të tjera me origjinë nga kafshët	01.42.2, 01.47.2, 01.49.2, 01.49.3
	01 .B	Peshkimi dhe produkte të tjera për peshkim	03
02		Qymyr dhe linjit; naftë bruto dhe gaz natyror	
	02.1	Qymyr dhe linjit	05
	02.2	Naftë bruto	06.1
	02.3	Gaz natyror	06.2
		Produktet metalike dhe të minierave dhe produkte të tjera të guroveve; torfe; uranium dhe torium	
	03.1	Xehërorë (minerale) hekur	07.1
	03.2	Xehërorë bakri (përfshijë uranium dhe torium)	07.29
	03.3	Kalcium natyror ose kalcium, fosfateve alumini	08.91
	03.4	Kripë	08.93
	03.5	Gur, rëre, zhavorr, argjilë, bitum dhe produkte të tjera të minierave dhe të guroveve	08.1, 08.92, 08.99
	03.6	Uraniumi dhe torium	07.21
04		Produkte ushqimore, pijeve dhe duhanit	
	04.1	Mish, lëkura të papërpunuara dhe produkteve të mishit	10.1
	04.2	Peshku dhe produktet e peshkut, të përpunuara dhe të konservuara	10.2
	04.3	Fruta dhe perime, të përpunuara dhe të konservuara	10.3
	04.4	Yndyra e vajra shtazore dhe bimore	10.4
	04.5	Produktet e qumështit dhe akullore	10.5
	04.6	Produkte të bluara drithi, niseshte, produkte niseshteje dhe ushqim i përgatitur për kafshë	10.6, 10.9
	04.7	Pije	11
	04.8	Produkte të tjera ushqimore n.e.c. dhe produktet e duhanit (përveç produkteve të paketuara dhe të grupuara)	10.7, 10.8, 12
	04.9	Produkte të ndryshme ushqimore dhe produktet e duhanit të paketuara ose të grupuara	Varion 10, 11 ou 12



05		Tekstile dhe produkte tekstili; lëkurë dhe produkte lëkure	
	05.1	Tekstile	13
	05.2	Veshje të jashtme dhe artikujt prej gëzofi	14
	05.3	Lëkurë dhe produkte lëkure	15
06		Druri dhe produktet e drurit dhe produktet me tapë (përveç mobilieve); artikujt prej kashte dhe materialeve thurëse; pulpë, letër dhe produkte letre; materialet e shtypura dhe mediat e regjistruara	
	06.1	Produktet prej druri dhe tape (përveç mobilieve)	16
	06.2	Brumi që përgatitet letra, letër dhe produkte letre	17
	06.3	Materialet e shtypura dhe mediat e regjistruara	18, 58, 59
07		Koks dhe produktet e rafinuara të naftës	
	07.1	Produktet e furrës koks, briketa, forma vezake dhe lëndë djegëse të ngurta të ngjashme	19.1, 19.20.1
	07.2	Produktet e naftës të lëngshme të rafinuar	19.20.2
	07.3	Produkte të lëngshëm, gaztë ose të ngjeshur të naftës	19.20.3
	07.4	Produktet e ngurta ose naftë e rafinuar graso	19.20.4
08		Kimikate, produkte kimike dhe fibra të bëra nga njeriu; produkte gome dhe plastike, karburant bërthamor	
	08.1	Produkte kimike me bazë minerale	20.11, 20.12, 20.13.2, 20.13.3, 20.13.4, 20.13.5, 20.13.6
	08.2	Produkte kimike me bazë organike	20.14
	08.3	Komponimet e azotit dhe plehra (përveç plehrave natyrore)	20.15
	08.4	Plastikë bazë dhe gomë sintetike në forma primare	20.16, 20.17
	08.5	Farmaceutike dhe parakimike, duke përfshirë pesticide dhe produkte agro-kimike të tjera	20.2, 20.3, 20.4, 20.5, 20.6, 21
	08.6	Produkte gome ose plastike	22
	08.7	Karburant bërthamor	20.13.1
09		Produkte të tjera minerale (jometalike)	
	09.1	Qelqi dhe produkte qelqi, qeramike dhe produkte prej porcelani	23.1, 23.2, 23.3, 23.4
	09.2	Çimento, gëlqere dhe suva	23.5
	09.3	Materialet ndërtimi të tjera	23.6, 23.7, 23.9
10		Metale bazë; produkte metalike të fabrikuara, përveç makinerive dhe pajisjeve	



	10.1	Produkte bazë hekuri dhe çelikut dhe produkte ferro-lidhjeve dhe produkte të përpunimit të parë të hekurit dhe çelikut (me përjashtim të tubave)	24.1, 24.3
	10.2	Metale jongjyra dhe produkte prej tyre	24.4
	10.3	Tubat, gypat, profilet dhe pajisje të ngjashme	24.2, 24.5
	10.4	Produkte metalike strukturore	25.1
	10.5	Boljerë, hardware, armë dhe produkte të tjera të fabrikuara metalike	25.2, 25.3, 25.4, 25.7, 25.9
11		Makineri dhe pajisje; Pajisje zyre dhe kompjuterë; makineri elektrike dhe aparatura si radio, televizion dhe pajisjet e komunikimit; instrumentet mjekësorë dhe orë	
	11.1	Makineri bujqësore dhe pyjore	28.3
	11.2	Pajisje të brendshëm të p.k.v. (white goods)	27.5
	11.3	Makineri, pajisje për zyra dhe kompjuter	26.2, 28.23
	11.4	Makineri dhe aparatet elektrike të p.k.v	27.1, 27.2, 27.3, 27.4, 27.9
	11.5	Komponentët elektronike dhe pajisje transmetimi	26.1, 26.3
	11.6	Televizion dhe radio marrës; regjistrues zëri dhe video apo aparatura për riprodhim dhe mallra të lidhura	26.4, 26.8
	11.7	Instrumente mjekësore, optike, orë dore dhe orë muri	26.5, 26.6, 26.7, 32.5
	11.8	Makina të tjera, vegla dhe pjesë për makina	28.1, 28.21, 28.22, 28.24, 28.25, 28.29, 28.4, 28.9
12		Pajisje transporti	
	12.1	Produkte të industrisë së automobilave	29
	12.2	Pajisje transporti të tjera	30
13		Mobilie; mallra të tjera të prodhuara	
	13.1	Mobilie	31
	13.2	Mallra të tjera të prodhuara	32.1, 32.2, 32.3, 32.4, 32.9
14		Lëndë të para të ricikluara; mbetjet e ngurta (bashkiake) dhe mbeturinat e tjera	
	14.1	Mbeturina shtëpiake dhe bashkiake	38.11.31
	14.2	Mbeturina të tjera ...	3 7.00.20, të tjera / 38.11, 38.12, 38.3
15		Pako postare	
	15.1	Postë	N.A. / pa objekt
	15.2	Sende të paketuara dhe pako të vogla Pako, paketa të vogla	N.A. / pa objekt
16		Pajisje dhe materiale që përdoren në transportin e mallrave	
	16.1	Kontejnerët dhe trupat që shërbejnë për shkëmbim, bosh	N.A. / pa objekt
	16.2	Paleta dhe paketime të tjera në shërbim, bosh	N.A. / pa objekt



17		Mallra të lëvizura në rrugën për zhvendosjen e familjeve dhe zyrave; bagazheve të transportuara të ndara nga ato të udhëtarëve; automjete të transportuara për riparim; mallra jotregtare të tjera	
	17.1 17.2 17.3 17.4 17.5	Largimin (zhvendosjen) e familjeve Bagazhe dhe artikuj që i shoqërojnë udhëtarët Automjete për riparim Pajisjet e bimëve, skela Mallra të tjera jotregtare të paklasifikuara në një tjetër vend	N.A. / pa objekt N.A. / Pa objekt N.A. / pa objekt
18		Mallra të grupuara: një përzierje e llojeve të mallrave të cilat janë transportuar së bashku	
	18.0	Mallra të grupuara	N.A. / pa objekt
19		Mallra të paidentifikuara: mallrat që për ndonjë arsye nuk mund të identifikohen dhe për këtë arsye nuk mund të caktohen në grupet nga 01–16	
	19.1 19.2	Mallra të paidentifikueshme në kontejnerë ose në trupat e shkëmbimit Mallra të tjera të paidentifikuara	N.A. / pa objekt N.A. / pa objekt
20		Mallra të tjera	
	20.0	Mallra të tjera të paklasifikuara në një tjetër vend	N.A. / pa objekt

VENDIM

Nr. 138, datë 20.3.2019

**PËR DISA SHITESA DHE
NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 187,
DATË 8.3.2017, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E
STRUKTURËS DHE TË NIVELEVE TË
PAGAVE TË NËPUNËSVE
CIVILË/NËPUNËSVE,
ZËVENDËSMINISTRIT DHE
NËPUNËSVE TË KABINETEVE, NË
KRYEMINISTRI, APARATET E
MINISTRIVE TË LINJËS,
ADMINISTRATËN E PRESIDENTIT,
KUVENDIT, KOMISIONIT QENDROR
TË ZGJEDHJEVE, GJYKATËN E LARTË,
PROKURORINË E PËRGJITHSHME,
DISA INSTITUCIONE TË PAVARURA,
INSTITUCIONET NË VARËSI TË
KRYEMINISTRIT, INSTITUCIONET NË
VARËSI TË MINISTRAVE TË LINJËS
DHE ADMINISTRATËN E
PREFEKTIT”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 2, të nenit 4, të ligjit nr. 10405, datë 24.3.2011, “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”, të pikës 2, të nenit

7, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, të ligjit nr. 9584, datë 17.7.2006, “Për pagat, strukturat dhe shpërblimet e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe të institucioneve të tjera të pavarura, të krijuara me ligj”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 99/2018, “Për buxhetin e vitit 2019”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 187, datë 8.3.2017, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen shtesat dhe ndryshimet, si më poshtë vijon:

a) Në fund të pikës 1/3/a shtohet emërtesa “Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar”;

b) Në shkronjën “b”, të pikës 1/3:

i) emërtesat “Instituti i Zhvillimit të Arsimit” dhe “Inspektorati Shtetëror i Arsimit” shfuqizohen;

ii) shtohet emërtesa “Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar”.

c) Pas pikës 9/13 të shtohet pika 9/14, si më poshtë vijon:

“9/14. Kategoritë e pagave të pozicioneve të punës së nëpunësve për emërtesat “Specialist” deri në “Titullar i institucionit” në Drejtorinë Qendrore të Drejtorisë së Përgjithshme të



Arsimit Parauniversitar janë sipas lidhjes nr. 6/14, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.”.

ç) Pika 12/1 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“12/1. Kategoritë e pagave të pozicioneve të punës së nëpunësve për emërtesat “Specialist” deri në “Titullar institucioni” në drejtoritë rajonale të arsimit parauniversitar dhe zyrat vendore të arsimit parauniversitar janë sipas lidhjes nr. 9/1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.”.

2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi për vitin 2019, të përballohen nga fondet e miratuara për secilin institucion dhe të fillojnë nga momenti i transferimit apo emërimit të nëpunësve në pozicionet e reja, pas miratimit të strukturave dhe organikave përkatëse.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Erion Braçe

Lidhja nr. 6/14

Kategoritë e pagave të pozicioneve të punës së nëpunësve për emërtesat “Specialist” deri në “Titullar institucioni” në Drejtorinë Qendrore të Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar, si dhe shtesa e kualifikimit

POZICIONI	KATEGORIA	KRITERI MINIMAL I DIPLOMËS SË SHKOLLËS SË LARTË PËR EFEKT TË PRANIMIT NË POZICIONIN PËRKATËS TË PUNËS PAGA E GRUPIT	SHTESA E KUALIFIKIMIT
Titullar i institucionit	II-a	1	Shkalla e tretë (“Mësues i kualifikuar”) - 30% Shkalla e dytë (“Mësues specialist”) - 40% Shkalla e parë (“Mësues mjeshtr”) - 50%
Përgjegjës sektori në sektorët e përmbajtjes	III-a/1	1	Shkalla e tretë (“Mësues i kualifikuar”) - 30% Shkalla e dytë (“Mësues specialist”) - 40% Shkalla e parë (“Mësues mjeshtr”) - 50%
Përgjegjës sektori në sektorët mbështetës	III-a/1	1	0
Specialist në sektorët e përmbajtjes	IV-a	1 ose 2 ose 3	Shkalla e tretë (“Mësues i kualifikuar”) - 30% Shkalla e dytë (“Mësues specialist”) - 40% Shkalla e parë (“Mësues mjeshtr”) - 50%
Specialist në sektorët mbështetës	IV-a	1 ose 2 ose 3	0
	IV-b		

Shtesa për kualifikim jepet sipas dëshmisë së kualifikimit individual dhe llogaritet mbi pagën e grupit.



Lidhja nr. 9/1

Kategoritë e pagave të pozicioneve të punës së nëpunësve për emërtesat “Specialist” deri në “Titullar institucioni” në drejtoritë rajonale të arsimit parauniversitar dhe zyrat vendore të arsimit parauniversitar, si dhe shtesa e kualifikimit

POZICIONI	KATEGORIA	KRITERI MINIMAL I DIPLOMËS SË SHKOLLËS SË LARTË PËR EFEKT TË PRANIMIT NË POZICIONIN PËRKATËS TË PUNËS PAGA E GRUPIT	SHTESA E KUALIFIKIMIT
Drejtor i drejtorive rajonale të arsimit parauniversitar	III-b	1	Shkalla e tretë (“Mësues i kualifikuar”) - 30% Shkalla e dytë (“Mësues specialist”) - 40% Shkalla e parë (“Mësues mjeshtrë”) - 50%
Drejtor i zyrave vendore të arsimit parauniversitar; përgjegjës sektori në drejtoritë rajonale të arsimit parauniversitar	IV-a	1	Shkalla e tretë (“Mësues i kualifikuar”) - 30% Shkalla e dytë (“Mësues specialist”) - 40% Shkalla e parë (“Mësues mjeshtrë”) - 50%
Përgjegjës sektori në zyrat vendore të arsimit parauniversitar	IV-b	1	Shkalla e tretë (“Mësues i kualifikuar”) - 30% Shkalla e dytë (“Mësues specialist”) - 40% Shkalla e parë (“Mësues mjeshtrë”) - 50%
Specialist në drejtoritë rajonale të arsimit parauniversitar	IV-b	1 ose 2 ose 3	Shkalla e tretë (“Mësues i kualifikuar”) - 30% Shkalla e dytë (“Mësues specialist”) - 40% Shkalla e parë (“Mësues mjeshtrë”) - 50%
Specialist në zyrat vendore të arsimit parauniversitar	IV-c	1 ose 2 ose 3	Shkalla e tretë (“Mësues i kualifikuar”) - 30% Shkalla e dytë (“Mësues specialist”) - 40% Shkalla e parë (“Mësues mjeshtrë”) - 50%

Shtesa për kualifikim jepet sipas dëshmisë së kualifikimit individual dhe llogaritet mbi pagën e grupit.

**VENDIM**

Nr. 139, datë 20.3.2019

**PËR DISA NDRYSHIME DHE
SHTESA NË VENDIMIN NR. 867, DATË
10.12.2014, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, “PËR PROCEDURAT E
BASHKËPUNIMIT NË
INSTITUCIONET E ADMINISTRATËS
SHTETËRORE”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 5, të nenit 24, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në kreun II, të vendimit nr. 867, datë 10.12.2014, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Pika 1 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“1. Institucionet e administratës shtetërore, nëpërmjet kësaj procedure, kanë të drejtë:

a) të kërkojnë nga institucionet e tjera të administratës shtetërore që t’u sigurohen të dhëna, informacione apo çdo lloj ndihme tjetër, të cilat janë të nevojshme për realizimin e detyrave funksionale të tyre;

b) të krijojnë rrjete profesionale ndërinstitucionale të nëpunësve për fusha të caktuara, të cilat kontribuojnë në rritjen e nivelit të bashkëpunimit dhe komunikimit, me synimin e:

i. shkëmbimit të eksperiencave më të mira, njohurive dhe praktikave për procese pune të ngjashme;

ii. shkëmbimit/krahasimit të informacionit apo të të dhënave në fushën përkatëse;

iii. diskutimit të çështjeve apo problematikave;

iv. adresimit të kërkesave pranë institucioneve përgjegjëse për të bërë rregullime të posaçme nëpërmjet akteve rregullatore që mbulojnë fushën përkatëse.”

2. Paragrafi i parë, i pikës 2, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Bashkëpunimi, sipas shkronjës “a”, të pikës 1, të kreut II, të këtij vendimi, mund të shfaqet në një nga format e mëposhtme:”

3. Pas pikës 22, shtohen pikat 23, 24 e 25, me këtë përmbajtje:

“23. Rrjetet profesionale ndërinstitucionale të

nëpunësve, sipas shkronjës “b”, të pikës 1, të kreut II, të këtij vendimi, krijohen për të trajtuar çështje, të cilat lidhen me qëllimin e ekzistencës dhe/ose fushën e përgjegjësisë së institucionit që i krijon. Në to marrin pjesë nëpunës/punonjës të institucioneve të administratës shtetërore, të cilët janë të punësuar në njësitë organizative të ngarkuara me ekzekutimin e detyrave që lidhen me fushën për të cilën krijohet rrjeti dhe kanë njohuri e aftësi më të mira në këtë fushë.

24. Rrjetet profesionale ndërinstitucionale të nëpunësve ngrihen me urdhër të Kryeministrit, ministrit përkatës apo titullarit të institucionit, që ka në fushë përgjegjësie fushën për të cilën ngrihet rrjeti. Në urdhrin e ngritjes së rrjetit përcaktohen qëllimi, synimet e përfitimet, struktura udhëheqëse, struktura të tjera në përbërje të tij, nëse është rasti, anëtarët, detyrat e përgjegjësitë, mënyra e organizimit e funksionimit të tij dhe numri maksimal i anëtarëve. Si rregull, në përbërje të rrjetit nuk mund të ketë më shumë se 30 (tridhjetë) anëtarë.

25. Si rregull, struktura udhëheqëse e rrjetit profesional ndërinstitucional të nëpunësve është institucioni/njësia organizative, që ka kompetencat më të larta sa i takon fushës në të cilën ngrihet rrjeti.”

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI

Erion Braçe

VENDIM

Nr. 140, datë 20.3.2019

**PËR MIRATIMIN E PARAQITJES, TË
FORMËS DHE TË SHENJAVE
DALLUESE TË UNIFORMËS, NË NJËSI
TË VEÇANTA TË SHËRBIMIT
INFORMATIV TË SHTETIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, dhe të nenit 33, të ligjit nr. 9357, datë 17.3.2005, “Për statusin e punonjësit të Shërbimit Informativ të Shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e paraqitjes, të formës dhe të shenjave dalluese të uniformave për njësi të



veçanta të Shërbimit Informativ të Shtetit (njësisë përgjegjëse për sigurimin fizik të objekteve dhe informacionit të klasifikuar), që përdoren vetëm gjatë ushtrimit të detyrës.

2. Shenjat dalluese të Shërbimit Informativ të Shtetit janë logoja, numri i identifikimit dhe shiriti me fjalën “SIGURIA”, në uniformë. Paraqitja, forma dhe specifikimet teknike të shenjave dalluese të shërbimit, që do të vendosen në uniformë, janë të përcaktuara në aneksin 1, bashkëlidhur këtij vendimi.

3. Llojet e uniformës, që do të ketë në përdorim kjo njësi, janë:

- a) uniforma dimërore;
- b) uniforma verore.

4. Paraqitja, forma dhe specifikimet teknike të uniformës së shërbimit janë të përcaktuara në aneksin 2, bashkëlidhur këtij vendimi.

5. Drejtori i Shërbimit Informativ të Shtetit, me urdhër, miraton:

- a) normat e furnizimit me veshmbathje të punonjësve të kësaj njësie;
- b) rregulloren e përdorimit të uniformës së kësaj njësie;
- c) specifikimet dhe kushtet teknike të zbatimit të uniformës, të shenjave dhe të elementeve të tjera.

6. Shenjat dalluese të Shërbimit Informativ të Shtetit, të miratuara sipas këtij vendimi, për nga qëllimi i përdorimit, janë pronë e Shërbimit Informativ të Shtetit dhe përdoren vetëm gjatë ushtrimit të detyrës.

7. Shenjat dalluese të Shërbimit Informativ të Shtetit janë të patjetërsueshme. Ndalohet shumëfishimi dhe realizimi i modeleve e i ngjyrave të tyre, për përdorues të institucioneve apo të subjekteve të tjera.

8. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi të përballohen nga buxheti i vitit 2019, miratuar për programin buxhetor të Shërbimit Informativ të Shtetit.

9. Ngarkohet Shërbimi Informativ i Shtetit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Erion Braçe

ANEKSI 2 UNIFORMA

INDEKSI

I. UNIFORMA DIMËRORE

1. Xhup me veshje të ngrohtë, blu i errët
2. Kostum i zi, material i trashë
3. Këmishë me mëngë të gjata, ngjyrë bezhë e çelur

4. Kravatë me ngjyrat e logos zyrtare të SHISH-it

5. Këpucë me qafa dimërore, të zeza
6. Pulovër e trikotuar jakë “V”, blu e errët
7. Kapelë tip sportive, blu e errët, me logo

II. UNIFORMA VERORE

1. Kostum i zi, material i hollë
2. Këmishë me mëngë të shkurtra, ngjyrë bezhë e çelur
3. Këpucë gjysmëverore, të zeza
4. Kravatë me ngjyrat e logos zyrtare të SHISH-it



I. UNIFORMA DIMËRORE

1. Xhup me veshje të ngrohtë, blu i errët



2. Kostum i zi, material i trashë





3. Këmishë me mëngë të gjata,
ngjyrë bezhë e çelur



4. Kravatë me ngjyrat e logos zyrtare
të SHISH



5. Këpucë me qafa dimërore, të zeza



6. Pulovër e trikotuar jakë “V”, blu e errët



7. Kapelë tip sportive, blu e errët, me logo



II. UNIFORMA VERORE

1. Kostum i zi, material i hollë



2. Këmishë me mëngë të shkurtra, ngjyrë bezhë e çelur



3. Këpucë gjysma verore, të zeza



4. Kravatë me ngjyrat e logos zyrtare të SHISH



ANEKSI 1
SHENJAT

1. Logoja e Shërbimit Informativ të Shtetit
2. Shirit me numër identifikues
3. Shirit me fjalën “SIGURIA”

1. Logoja e Shërbimit Informativ të Shtetit

Logo me qëndisje me relief, e heqshme nga uniforma për këmishën me diametër 8 cm.
Logo e qëndisur në kapele me diametër 5 cm.

**2. Numri identifikues**

Numri identifikues i shkruar në shirit me ngjyrë blu si të logos zyrtare, i qëndisur me relief me përmasa 8 cm x 3 cm, i heqshëm për t'u vendosur në këmishë.

**3. Shirit me fjalën “SIGURIA”**

Fjala “SIGURIA” e shkruar në shirit me ngjyrë blu si të logos zyrtare, e qëndisur me relief me përmasa 8 cm x 3 cm, e heqshme për t'u vendosur në xhup.



**VENDIM**

Nr. 141, datë 20.3.2019

**PËR DISA NDRYSHIME NË
VENDIMIN NR. 718, DATË 29.10.2004,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE,
“PËR LISTËN E PERSONAVE TË
SHPALLUR SI FINANCUES
TË TERRORIZMIT”,
TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, pika 1, 14, pika 1, 18, pika 1, 25, pika 1, dhe 28, pika 1, të ligjit nr. 157/2013, “Për masat kundër financimit të terrorizmit”, me propozimin e Kryeministrit dhe ministër për Evropën dhe Punët e Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në listën e personave të shpallur sipas rezolutave të Këshillit të Sigurimit (“Lista e OKB-së”), që i bashkëlidhet vendimit nr. 718, datë 29.10.2004, të Këshillit të Ministrave, “Për listën e personave të shpallur si financues të terrorizmit”, të ndryshuar, të bëhet ndryshimi, si më poshtë vijon:

Në listën e shkronjës “C”, të titulluar “Lista e individëve anëtarë ose bashkëpunëtorë me organizatat ISIL (Da’esh) dhe AL-Qaida”, shtohet individi i renditur në shkronjën “a”, sipas shtesës bashkëlidhur këtij vendimi, në listën e konsoliduar të Këshillit të Sigurimit të OKB-së, për persona që janë anëtarë, bashkëpunëtorë apo financues të organizatave ISIL (Da’esh) dhe AL-Qaida”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**ZËVENDESKRYEMINISTRI
Erion Braçe**

**PËRDITËSIMI NË LISTËN E
PERSONAVE TË SHPALLUR SI
FINANCUES TË TERRORIZMIT SIPAS
REZOLUTAVE TË KËSHILLIT TË
SIGURIMIT TË OKB-SË
 (“LISTA E OKB-së”)**

**C. LISTA E INDIVIDËVE ANËTARË OSE
BASHKËPUNËTORË ME ORGANIZATAT
ISIL (DA’ESH) DHE AL-QAIDA”:**

Lista e shtuar në “Lista e individëve anëtarë ose bashkëpunëtorë me organizatat ISIL (Da’esh) dhe AL-Qaida”:

1: HAMZA 2: USAMA 3: MUHAMMAD 4:
BIN LADEN

Shënim. Gjeneralitetet e tjera për personin emri i të cilit është renditur më sipër, mbahen në Drejtorinë e Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave.

VENDIM

Nr. 142, datë 20.3.2019

**PËR KALIMIN NË PRONËSI, NGA
MINISTRIA E MBROJTJES TE BASHKIA
TIRANË, TË NJË SIPËRFAQEJE
TRUALLI FUNKSIONAL DHE OBJEKTI,
BRENDA TERRITORIT TË PRONËS
NR. 42, ME EMËRTIM “INSTITUTI I
STUDIMEVEDHE PROJEKTIMEVE TË
MBROJTJES”, ME VENDNDODHJE
BULEVARDI “ZHAN D’ARKË”, TIRANË,
DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.
572, DATË 3.9.2014, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, “PËR DHËNIEN NË
PËRDORIM TË PËRKOHSHËM, NGA
MINISTRIA E MBROJTJES MINISTRISË
SË PUNËVE TË BRENDSHME, TË
OBJEKTIT NR. 42, ME EMËRTIM
“INSTITUTI I STUDIMEVE DHE
PROJEKTIMEVE TË MBROJTJES”, PËR
SHKOLLËN SHQIPTARE TË
ADMINISTRATËS PUBLIKE, DHE
SHFUQIZIMIN E VENDIMIT NR. 786,
DATË 14.11.2012, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE”, DHE NË VENDIMIN
NR. 515, DATË 18.7.2003, TË KËSHILLIT
TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E
LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE
TË PALUAJTSHME SHTETËRORE, TË
CILAT I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI
ADMINISTRIMI MINISTRISË SË
MBROJTJES”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13 e 15, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, dhe të neneve 3, 5, 7 e 8, të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001, “Për transferimin e pronave të paluajtshme të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave



VENDOSI:

1. Kalimin në pronësi, nga Ministria e Mbrojtjes të Bashkia Tiranë, të një sipërfaqeje truall funksional dhe objekti, me sipërfaqe të përgjithshme 766 (shtatëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë) m², nga truall funksional i pronës nr. 42, me emërtim “Instituti i Studimeve dhe Projektive të Mbrojtjes”, me vendndodhje bulevardi “Zhan D’Ark”, Tiranë, sipas planvendosjes që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij, për ta përdorur për nevoja urbanistike, për ndërtim rruge publike.

2. Në listën e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, që i bashkëlidhet vendimit nr. 515, datë 18.7.2003, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Mbrojtjes”, të ndryshuar, hiqet sipërfaqja 766 (shtatëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë) m², nga truall funksional i pronës nr. 42, me emërtim “Instituti i Studimeve dhe Projektive të Mbrojtjes”, me vendndodhje bulevardi “Zhan D’Ark”, Tiranë, sipas planvendosjes, dhe shtohet në listën e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore që i kanë kaluar në pronësi ose përdorim Bashkisë Tiranë.

3. Bashkisë Tiranë i ndalohet të ndryshojë destinacionin e përdorimit të sipërfaqes së pronës, të përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi, ta tjetërsojë atë ose t’ua japë në përdorim të tretëve.

4. Për sigurinë dhe ruajtjen e pronës, para fillimit të punimeve, Bashkia Tiranë të ndërtojë rrethimin në kufijtë e rinj të pronës dhe portën hyrëse, me kangjella metalike dhe me bazament betonarme, duke i kthyer në gjendjen e tyre të mëparshme, të kryejë spostimin e rrjeteve

inxhinierike, që prek gjurma e rrugës, sipas parametrave dhe kushteve teknike, dhe për këtë të hartohet aktmarrëveshje ndërmjet Bashkisë Tiranë dhe Ministrisë së Mbrojtjes, të përfaqësuar nga Instituti i Gjeografisë dhe Infrastrukturës Ushtarake.

5. Në vendimin nr. 572, datë 3.9.2014, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime:

a) Në titullin e vendimit, fjalët “... Ministrisë së Punëve të Brendshme ...” shfuqizohen;

b) Pika 1, e vendimit, riformulohet, si më poshtë vijon:

“1. Dhënie në përdorim të përkohshëm, për një periudhë 40-vjeçare, të objektit nr. 42, me emërtim “Instituti i Studimeve dhe Projektive të Mbrojtjes”, nga Ministria e Mbrojtjes të Shkollës Shqiptare e Administratës Publike”, të truallit funksional dhe objektit me sipërfaqe të përgjithshme 1077.28 (një mijë e shtatëdhjetë e shtatë pikë njëzet e tetë) m², sipas planvendosjes që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij, për ta përdorur për nevojat e administratës së këtij institucioni.”

c) Në pikën 2, të vendimit, fjalët “... Ministrisë së Punëve të Brendshme ...”, zëvendësohen me “... Shkollës Shqiptare të Administratës Publike ...”.

6. Ngarkohen ministri i Mbrojtjes, kryetari i Bashkisë Tiranë, drejtori i Shkollës Shqiptare të Administratës Publike, Agjencia e Inventarizimit dhe Transferimit të Pronave të Paluajtshme dhe kryeregjistruesi i Republikës së Shqipërisë për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.


Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Erion Braçe



PLAN VENDOSJA

e Pronës nr. 42 "Instituti i Studimeve dhe Projektimeve të Mbrojtjes", Tiranë
Objekti dhe Sip. e truallit që kërkohet për kalim në pronësi të Bashkisë Tiranë.



- Shpjeguese**
Sip. e përgj. e pronës nr.42 = 1 843.28m²
- Sip. e përgj. që i transferohet Bashkisë Tiranë = 766m²
 - Sip. e objektit që i transferohet Bashkisë Tiranë = 93m²
 - Sip. e përgj. që i mbetet pronës nr.42 = 1077.28 m²
Sip. nën objekt që i mbetet pronës nr.42 = 602 m²
 - Kufiri i Pronës


Sherim : Kjo planvendosje u hartua në zbatim të shkresës së Sekretarit të Përgjithshëm të MM nr.6794/7, datë 02.10.2018, bazuar mbi matjet e kryera në terren më datë 28.08 2018 në prani të përfaqësuesve të projektit dhe të Bashkisë Tiranë, dokumentacionin hartografik b/lidhur shkresës të Bashkisë Tiranë nr.28680/4, datë 01.10.2018 dhe dokumentacionit teknik të kësaj prone marrë në arkivin e IGJIU.

Hartuar 03.10.2018

Shkalla 1:1000

DREJTORI I IGJIU
N/Kol. Ark. Ferdi HYRAJ

PUNOI
Topograf Ramiz HAXHIU



**VENDIM****Nr. 143, datë 20.3.2019**

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES
PUBLIK, TË PRONARIT TË PASURISË
SË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE,
QË PREKET NGA REALIZIMI I
PROJEKTIT “RIKONSTRUKSION
I RRUGËS UNAZA PATOS”,
NË BASHKINË PATOS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, me propozimin e ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarit të pasurisë së paluajtshme, pronë private, që preket nga realizimi i projektit “Rikonstruksion i rrugës unaza Patos”, në Bashkinë Patos.

2. Shpronësimi të bëhet në favor të Bashkisë Patos.

3. Pronari i pasurisë së paluajtshme, që shpronësohet, të kompensohet në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse që paraqitet në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, për pasurinë “ndërtesë”, me sipërfaqe 19 m², me vlerë të përgjithshme 566 827,15 (pesëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e tetëqind e njëzet e shtatë presje pesëmbëdhjetë) lekë, si dhe për pasurinë “truall”, me sipërfaqe 19 m², me vlerë 54 112 (pesëdhjetë e katër mijë e njëqind e dymbëdhjetë) lekë.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 620 939, 15 (gjashtëqind e njëzet mijë e nëntëqind e tridhjetë e nëntë presje

pesëmbëdhjetë) lekësh, të përballohet nga të ardhurat e Bashkisë Patos, planifikuar në buxhetin e saj.

5. Afati i përfundimit të shpronësimit të jetë tre muaj pas datës së hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

6. Pronari i pasurisë së paluajtshme, që shpronësohet, sipas tabelës bashkëlidhur këtij vendimi, të kompensohet, për efekt shpronësimi, pasi të ketë paraqitur pranë Bashkisë Patos certifikatën e pronësisë, hartën treguese të regjistrimit si dhe kartelën e pasurisë.

7. Afati i përfundimit të punimeve të objektit në Bashkinë Patos të jetë në përputhje me afatet e parashikuara nga kjo bashki.

8. Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Fier, brenda 30 ditëve, nga data e miratimit të këtij vendimi, në bashkëpunim me Bashkinë Patos, të fillojë procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit në hartën kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar, dhe të bëjë kalimin e pronësisë, për pasuritë e shpronësuara, në favor të Bashkisë Patos.

9. Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Fier të pezullojë të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara, deri në momentin kur do të realizohen procesi i hedhjes së gjurmës së projektit në hartën kadastrale dhe kalimi i pronësisë, për pasuritë e shpronësuara.

10. Ngarkohen Ministria e Brendshme, Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Fier dhe Bashkia Patos për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI

Erion Braçe

**LISTA E PRONAVE DHE EMRI I PRONARIT QË DO TË SHPRONËSOHET PËR REALIZIMIN E
PROJEKTIT “RIKONSTRUKSION I RRUGËS UNAZA PATOS”, NË BASHKINË E PATOSIT**

Nr.	Emër mbiemër	Z.K	Nr. i pasurisë	Sip. truall/m ²	Çmimi lekë/m ²	Vlera trualli	Sip. ndërtesës/m ²	Vlera e ndërtesës	Vlera totale	Dokumenti i pronësisë
1	Lefter Rauf Manaj	2890	4/130	19	2848.00	54112.00	19.00	566827,15	620939,15	Konfir. ZVRPP
Totali									620 939,15	

**VENDIM**

Nr. 144, datë 20.3.2019

**PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES
SË FINANCIMIT, NDËRMJET
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË,
PËRFAQËSUAR NGA MINISTRIA E
FINANCAVE DHE EKONOMISË
(MARRËSI) DHE KfW FRANKFURT AM
MAIN (KfW), PËR FINANCIMIN E
SHËRBIMEVE NDËRKOMBËTARE
KËSHILLIMORE PËR MENAXHIM PËR
MASA SHOQËRUESE NË KUADËR TË
PROGRAMIT “LINJA UNAZORE 110 kV E
SHQIPËRISË SË JUGUT”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 19 e 22, të ligjit nr. 43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e marrëveshjes së financimit, ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë (marrësi), dhe KfW Frankfurt am Main (KfW), për financimin e shërbimeve ndërkombëtare këshillimore për menaxhim për masa shoqëruese në kuadër të programit “Linja unazore 110 kv e Shqipërisë së Jugut”, me një grant në shumën prej 2 000 000 (dy milionë) eurosh, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Erion Braçe

MARRËVESHJE FINANCIMI
E DATËS 20.12.2018 NDËRMJET KfW,
FRANKFURT AM MAIN (“KfW”) DHE
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË TË
PËRFAQËSUAR NGA MINISTRIA E
FINANCAVE DHE EKONOMISË
 (“MARRËSI”)
PËR SHUMËN 2,000,000.00 EURO

Shërbimet Ndërkombëtar Këshillimore për Menaxhim
Masa Shoqëruese në kuadër të Programit “Linja Unazore
110kV e Shqipërisë së Jugut”
BMZ-nr. 2014 70 095

Në bazë të një marrëveshjeje të datës 9 dhjetor 2015 ndërmjet Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë për Bashkëpunimin Financiar 2014, për masat shoqëruese mbi programin “Linja unazore 110kV e Shqipërisë së Jugut” (Përmirësimi i Eficiencës në Sektorin e Energjisë) (“Marrëveshja qeveritare”), Marrësi dhe KfW-ja, lidhin Marrëveshjen e mëposhtme të Financimit (“Marrëveshja e financimit”).

Marrëveshja e financimit është pjesë e programit “Linja unazore 110kV e Shqipërisë së Jugut” (“Programi”) dhe lidhet me masat përforcuese institucionale në sektorin e shpërndarjes së energjisë.

Neni 1**Shuma dhe qëllimi i kontributit financiar**

1.1 KfW-ja do t’i japë Marrësit një kontribut financiar që nuk kalon shumën

2,000,000.00 EURO

(me fjalë: dy milionë euro)

Ky “Kontribut financiar” nuk do të jetë i kthyesëm, përveç kur përcaktohet ndryshe në nenin 3.2.

1.2 Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë do të veprojë në kuadrin e këtij Programi si Ministri e Zbatimit të Projektit (“PIM”).

Marrësi, në këtë rast i përfaqësuar nga PIM-i, do të përdorë kontributin financiar ekskluzivisht për shërbime konsulence për masat e forcimit institucional të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes të OSHEE-së (“OSHEE”) nëpërmjet Shërbimeve të Konsulentëve Ndërkombëtarë për Menaxhim brenda masave shoqëruese të Programit, si dhe do të paguajë kostot e këmbimit valutator.

PIM-i dhe KfW-ja do të përcaktojnë detajet dhe objektin e Shërbimeve Këshilluese Ndërkombëtare për Menaxhim që do të financohen nga kontributi financiar me anë të një marrëveshjeje të veçantë, e cila do të nënshkruhet nga Marrësi, i përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë (“Marrëveshja e veçantë”).

1.3 Marrësi dhe KfW-ja do të përcaktojnë hollësisht në marrëveshjen e veçantë kontributin që do të jepet nga Marrësi. Marrësi do të verë në dispozicion kontributin përkatës të plotë dhe në kohën e duhur. Marrësi do t’i verë në dispozicion KfW-së, me kërkesën e saj, prova që dëshmojnë masat e ndërmarrja në këtë drejtim.



1.4 Taksat dhe tarifat e tjera publike (përfshirë tatimin në burim) që i linden marrësit, si dhe detyrimet doganore nuk mund të financohen nga kontributi financiar.

Neni 2 Disbursimi

2.1 KfW-ja do të disbursojë kontributin financiar sipas ecurisë së Shërbimeve të Konsulencës Ndërkombëtare për Menaxhim dhe me kërkesë të Marrësit nëpërmjet PIM-it. Me anë të kontratës së veçantë, Marrësi dhe KfW-ja do të përcaktojnë procedurat e disbursimit, në veçanti, treguesit që vërtetojnë se fondet e disburuara janë përdorur për qëllimin e përcaktuar.

2.2 KfW-ja do të ketë të drejtë të refuzojë kryerjen e disbursimeve pas datës 31 dhjetor 2020 apo në një datë tjetër që mund të jetë miratuar midis dy palëve.

Neni 3 Pezullimi i disbursimeve dhe i shlyerjes

3.1 KfW-ja nuk mund të pezullojë disbursimet vetëm, nëse:

a) Marrësi nuk përmbush detyrimet e tij ndaj KfW-së për kryerjen e pagesave në kohën e përcaktuar;

b) janë shkelur detyrimet e përcaktuara në këtë Marrëveshje apo në marrëveshjet e veçanta përkatëse të kësaj Marrëveshjeje;

c) Marrësi, nëpërmjet PIM-it, nuk mund të vërtetojë se kontributi financiar është përdorur për qëllimin e përcaktuar;

d) përmbushja e detyrimeve të KfW-së sipas kësaj marrëveshjeje financiare shkel ligjin në fuqi; apo

e) linden rrethana të jashtëzakonshme që pengojnë apo rrezikojnë seriozisht zbatimin, apo qëllimin e Shërbimeve të Konsulencës Ndërkombëtare për Menaxhim.

3.2 KfW-ja mund të kërkojë ripagimin e menjëhershëm të kontributit financiar, nëse ka ndodhur një prej situatave të përcaktuara në nenin 3.1 b), c) dhe d) dhe nuk është eliminuar brenda periudhës së përcaktuar nga KfW-ja, e cila megjithatë do të jetë të paktën 30 ditë.

Në rastin e specifikuar në nenin 3.1 c), ripagimi do të kufizohet në shumën të tilla për të cilat Marrësi, nëpërmjet PIM-it, nuk ka mundur të vërtetojë se i ka përdorur për qëllimin e përcaktuar.

Faqe | 3484

Në rastin e specifikuar në nenin 3.1 d), ripagimi do të kufizohet në shumën të tilla, ku pagesa të Marrësi apo lënia e pagesës Marrësi përbën një shkelje të ligjit në fuqi.

Neni 4 Shpenzimet dhe pagesat publike

Marrësi do të mbulojë të gjitha taksat dhe tarifat e tjera që linden jashtë Republikës Federale të Gjermanisë për lidhjen dhe zbatimin e kësaj Marrëveshjeje, si dhe të gjitha shpenzimet e transferimit dhe konvertimit që rrjedhin në lidhje me lëvrimin e kontributit financiar.

Neni 5 Deklaratat kontraktuale dhe fuqia e përfaqësimit

5.1 Ministri i Financave dhe Ekonomisë dhe personat e emëruar dhe të autorizuar me nënshkrimet e ekzemplarëve të vërtetuara nga ai ose ajo, përfaqësojnë Marrësin në ekzekutimin e kësaj marrëveshjeje financimi. Ministri i Infrastrukturës dhe Energjisë dhe personat e caktuar prej tij ose saj në KM dhe me ekzemplarin e vërtetuar prej tij do të përfaqësojnë Marrësin në zbatimin e Shërbimeve Këshillimore Ndërkombëtare të Menaxhimit. Fuqia e përfaqësimit nuk do të përfundojë derisa të mos pranohet shprehimisht nga përfaqësuesi i Marrësit i autorizuar në atë kohë nga KfW-ja.

5.2 Ndryshimet ose shtesat e kësaj Marrëveshjeje dhe çdo njoftim dhe deklaratë e dorëzuar nga palët kontraktuese sipas kësaj Marrëveshjeje do të jetë me shkrim. Ministri i Ekonomisë dhe Financave është i autorizuar të nënshkruajë çdo amendament që duhet të miratohet nga Këshilli i Ministrave. Ndryshimet në këtë Marrëveshje që ndikojnë vetëm në periudhën e disponueshmërisë (neni 2.2) nuk kërkojnë miratimin paraprak nga Këshilli i Ministrave. Çdo njoftim apo deklaratë e tillë do të jetë pranuar sapa të ketë mbërritur në adresën vijuese të palës kontraktuese përkatëse ose në atë adresë tjetër të palës kontraktuese përkatëse të njoftuar palës tjetër kontraktuese.

Për KfW-në: KfW

Kodi postar 11 11 41

60046 Frankfurt am Main

Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë

Faks: +49 69 7431-2944



Për Marrësin: Ministria e Financave dhe Ekonomisë
Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, nr. 3
Tiranë
Shqipëri
Faks: +355 4222 8494

Neni 6

Shërbimet Ndërkombëtare Këshillimore

6.1 Marrësi, nëpërmjet PIM-it, duhet:

a) të përgatisë dhe të kryejë shërbimet ndërkombëtare këshillimore në përputhje me praktikat financiare dhe inxhinierike, sipas koncepteve të rëna dakord me Marrësin dhe KfW-në për shërbimet ndërkombëtare Këshillimore dhe në përfundim do të përfitojë shërbime të pavarura të konsulentëve inxhinierikë;

b) të sigurojë financimin e plotë të Shërbimeve Ndërkombëtare Këshillimore dhe t'i japë KfW-së, sipas kërkesës, provën që tregon se të gjitha kostot të cilat nuk janë paguar nga kontributi financiar, janë mbuluar;

c) të mbajë ose të marrë masa për mbajtjen e librave dhe të dhënave, të cilat tregojnë të gjitha kostot që lidhen me Shërbimet Ndërkombëtare Këshillimore dhe të identifikojë qartë shërbimet e financuara nga kontributi financiar;

d) t'i mundësojë përfaqësuesve të KfW-së të inspektojnë librat dhe të dhënat në çdo kohë dhe çdo dokument tjetër që lidhet me ekzekutimin e Shërbimeve Ndërkombëtare Këshillimore;

e) t'i japë KfW-së të gjithë informacionin dhe raportet mbi Shërbimet Ndërkombëtare Këshillimore dhe për progresin e tyre sipas kërkesës së KfW-së; dhe

f) sipas pëlqimit të tij, të informojë menjëherë KfW-në për të gjitha rrethanat që parandalojnë ose rrezikojnë ekzekutimin e Shërbimeve Ndërkombëtare Këshillimore ose qëllimin e tyre.

6.2 PIM-i dhe KfW-ja do të përcaktojnë detajet që lidhen me nenin 6.1 nëpërmjet marrëveshjes së veçantë, e cila do të siglohet nga Marrësi, i përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

Neni 7

Publikimi dhe transferimi i informacionit të lidhur me Shërbimet e Konsulencës Ndërkombëtare për Menaxhim

7.1 Për të qenë në përputhje me parimet e pranuar ndërkombëtare me transparencë dhe

efikasitetit maksimal në bashkëpunimin për zhvillim, KfW-ja publikon informacionin e zgjedhur (duke përfshirë raportet e vlerësimit) për Shërbimin e Konsulencës Ndërkombëtare për Menaxhim dhe mënyrën sesi është financuar gjatë bisedimeve para kontraktuale, ndërsa marrëveshja (marrëveshjet) në lidhje me Shërbimin e Konsulencës Ndërkombëtare për Menaxhim është (janë) duke u zbatuar dhe në fazën pas kontraktuale (në vijim e referuar si “e gjithë periudha”).

Informacioni publikohet rregullisht në faqen e internetit të KfW-së për fushën e tij të biznesit “Banka e Zhvillimit KfW” (<http://transparenz.kfw-entwicklungsbank.de/>).

Publikimi i informacionit (qoftë nga KfW-ja apo palët e treta, në përputhje me nenin 7.3 më poshtë) për Shërbimin e Konsulencës Ndërkombëtare për Menaxhim dhe mënyrën sesi janë financuar nuk përfshin ndonjë dokumentacion kontraktual, apo informacion të detajuar sensitiv financiar apo biznesi rreth palëve të treta të përfshira në program, apo financimin e tij, të tilla si:

a) Informacion në lidhje me të dhënat e brendshme financiare;

b) Strategjitë e biznesit;

c) Udhëzimet dhe raportet e brendshme të korporatës;

d) Të dhënat personale të personave fizikë;

e) Vlerësim i brendshëm i KfW-së për pozicionin financiar të palëve.

7.2 KfW-ja ndan informacionin e zgjedhur për Shërbimin e Konsulencës Ndërkombëtare për Menaxhim dhe mënyrën sesi janë financuar gjatë gjithë periudhës me subjektet e përmendura më poshtë, veçanërisht për të garantuar transparencë dhe efikasitet:

a) Filialet e KfW-së;

b) Republika Federale e Gjermanisë dhe organet, autoritetet, institucionet, agjencitë apo subjektet e saj kompetente;

c) Organizata të tjera zbatuese të përfshira në bashkëpunimin dypalësh gjerman për zhvillim, në veçanti, Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH;

d) Organizatat ndërkombëtare të përfshira në mbledhjen e statistikave dhe anëtarët e tyre, veçanërisht, Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik (OECD) dhe anëtarët e saj;

e) Banka Botërore.



7.3 Gjithashtu, Republika Federale e Gjermanisë i ka kërkuar KfW-së të ndajë informacionin e zgjedhur rreth Shërbimeve të Konsulencës Ndërkombëtare për Menaxhim dhe mënyrën e financimit të tyre gjatë të gjithë periudhës me subjektet e mëposhtme, të cilat publikojnë seksione përkatëse në funksion të:

a) Republika Federale e Gjermanisë për qëllimin e Nismës Ndërkombëtare për Transparencën e Ndihmave

(http://www.bmz.de/de/was_wir_machen/weg/transparenz-fuer-mehr-Wirksamkeit/index.html);

b) Tregtia dhe Investimi Gjerman, me qëllimin e Informacionit mbi tregun

(<http://www.gtai.de/GTAI/Navigation/DE/trade.FOO>):

c) OECD-ja, me qëllim raportimin e flukseve financiare në kuadër të bashkëpunimit për zhvillim (<http://stats.oecd.org/>);

d) Instituti Gjerman për Vlerësimin e Zhvillimit (Deval), me qëllim vlerësimin e bashkëpunimit të përgjithshëm gjerman për zhvillim për të garantuar transparencë dhe efikasitet (<http://www.deval.org/de/>).

7.4 KfW-ja rezervon të drejtën për të transferuar informacion te palët e treta (të përfshirë për qëllim publikimi) rreth Shërbimeve të Konsulencës Ndërkombëtare për Menaxhim dhe mënyrës së financimit të tyre gjatë të gjithë periudhës, me qëllim ruajtjen e interesave të ligjshme.

Informacioni nuk transferohet nga KfW-ja te palët e treta, nëse interesat e ligjshme të Marrësit në informacionin që nuk është transferuar janë më të rëndësishme se interesat e KfW-së në transferimin e informacionit. Interesat e ligjshme të Marrësit përfshijnë konfidencialitetin e informacionit sensitiv të përmendur në nenin 7.1, i cili është përjashtuar nga publikimi.

Gjithashtu, KfW-ja gëzon të drejtë të transferojë informacion te palët e treta, nëse është e nevojshme, për shkak të kërkesave statutores, apo rregullatore, ose të pohojë ose të mbrojë pretendimet ose të drejta të tjera ligjore në gjykatë ose procedurat administrative.

Neni 8

Dispozita të ndryshme

8.1 Marrësi do të garantojë se personat e ngarkuar për përgatitjen dhe zbatimin e

Shërbimeve të Konsulencës Ndërkombëtare për Menaxhim, dhënien e çdo kontrate për Shërbimet e Konsulencës Ndërkombëtare për Menaxhim që do të financohen dhe me disbursimet e kërkuara të shumave të Marrëveshjes Financiare nuk kërkojnë, supozojnë, bëjnë, japin, supozojnë ose marrin një premtime të pagesave të paligjshme apo avantazhe të tjera lidhur me këto detyra.

8.2 Marrësi nuk do të hyjë në asnjë transaksion apo nuk do të angazhohet në ndonjë veprimtari tjetër të lidhur me Shërbimet e Konsulencës Ndërkombëtare për Menaxhim, që përbën shkelle të embargos që rregullon tregtinë e jashtme apo të ashtuquajturat sanksione financiare të Këshillit të Sigurisë të Kombeve të Bashkuara apo të Republikës Federale të Gjermanisë.

8.3 Nëse një prej dispozitave të kësaj Marrëveshjeje Financiare është e pavlefshme, të gjitha dispozitat e tjera do të mbeten të pacenuara prej saj. Çdo boshllëk i krijuar do të plotësohet nga një dispozitë në përputhje me qëllimin e kësaj Marrëveshjeje Financiare.

8.4 Marrësi nuk mund të caktojë apo transferojë, lërë peng apo hipotekojë ndonjë pretendim nga Marrëveshja Financiare.

8.5 Marrëveshja Financiare do të rregullohet nga ligji i Republikës Federale të Gjermanisë. Vendi i përmbushjes do të jetë Frankfurt am Main.

8.6 Marrëdhëniet ligjore midis KfW-së dhe Marrësit të rregulluara me këtë Marrëveshje Financiare do të përfundojnë 6 vjet pas kryerjes së disbursimit të fundit.

8.7 Marrëveshja Financiare do të hyjë në fuqi sapo KfW-ja të ketë marrë nga Marrësi njoftimin me shkrim se procedurat ligjore të brendshme që duhen përmbushur nga Marrësi janë plotësuar.

Hartuar në 2 kopje origjinale në gjuhën angleze.

Frankfurt am Main,
Më 20 dhjetor 2018

KfW

Tirana,
Më 18 dhjetor 2018
Republika e Shqipërisë
Përfaqësuar nga Ministria e
Financave dhe Ekonomisë

**VENDIM**

Nr. 146, datë 20.3.2019

**PËR MIRATIMIN E KONTRATËS SË
KONCESIONIT/ PARTNERITET
PUBLIK PRIVAT, NDËRMJET
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, TË
PËRFAQËSUAR NGA MINISTRIA E
INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
DHE BASHKIMIT TË OPERATORËVE
EKONOMIKË “GLOBAL TECHNICAL
MECHANICS” SHPK DHE “BAMI”
SHPK, SI KONCESIONARI DHE
SHOQËRISË KONCESIONARE “KUKËS
INTERNATIONAL AIRPORT” SHPK,
PËR REHABILITIMIN, OPERIMIN,
TRANSFERIMIN E AEROPORTIT
TË KUKËSIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, si dhe të ligjit nr. 125/2013, “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e kontratës së koncesionit/partneritet publik privat, ndërmjet Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe bashkimit të operatorëve ekonomikë “Global Technical Mechanics” sh.p.k. dhe “Bami” sh.p.k., si koncesionari dhe shoqërisë koncesionare “Kukës International Airport” sh.p.k., për rehabilitimin, operimin, transferimin e Aeroportit të Kukësit.

2. Ngarkohet Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**ZËVENDESKRYEMINISTRI
Erion Braçe**

VENDIM

Nr. 148, datë 20.3.2019

**PËR PROCEDURËN QË ZBATON
SHËRBIMI I PROVËS NË RAST TË
MOSPËRMBUSHJES SË MASËS
ALTERNATIVE TË SHMANGIES NGA
NDJEKJA PENALE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 10, të nenit 72, të ligjit nr. 37/2017, “Kodi i Drejtësisë Penale për të Miturit”, me propozimin e ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Objekt i këtij vendimi është përcaktimi i procedurës që zbatohet nga Shërbimi i Provës në rastet e mospërmbushjes së kushteve dhe detyrimeve që burojnë prej masës alternative të shmangies nga ndjekja penale e të miturit.

2. Shërbimi i Provës, në ushtrimin e veprimtarisë së tij, udhëhiqet nga parimi i interesit më të lartë të të miturit dhe masa alternative e shmangies nga ndjekja penale u shërben më mirë qëllimeve të rishoqërizimit, rehabilitimit të të miturit dhe parandalimit të shkeljeve të ligjit përkundrejt vendosjes së tij nën përgjegjësinë penale dhe zbatimit të dënimit penal.

3. Kompetencat e Shërbimit të Provës, në rast mospërmbushjeje të kushteve dhe detyrimeve që burojnë prej masës së shmangies nga ndjekja penale për të miturit, janë, si më poshtë vijon:

a) ndjek dhe mbikëqyr detyrimet që rrjedhin nga masa e shmangies, si organ kompetent që zbaton edhe procedurën e përcaktuar në këtë vendim, për mospërmbushjen e masës alternative të shmangies nga ndjekja penale e të miturit;

b) informon menjëherë me shkrim prokurorin, duke i vënë në dispozicion raportin e vlerësimit, sipas pikës 5 të këtij vendimi, i cili ka dhënë vendimin e masës së shmangies nga ndjekja penale për të miturin lidhur me kohën, vendin, mënyrën dhe rrethanat e mospërmbushjes së masës së shmangies, si dhe situatën personale të të miturit, vlerësuar në përputhje me pikat 1 e 2, të nenit 22, të ligjit nr. 37/2017, dhe të japë mendimin e tij.

c) informon menjëherë me shkrim të miturin me masën alternative të shmangies nga ndjekja penale, prindërit ose, sipas rastit, kujdestarin/përfaqësuesin ligjor lidhur me pasojat e moszbatimit të kushteve dhe detyrimeve të masës



së shmangies dhe rregullat e shqyrtimit në rast mospërbushjeje.

4. Në rastet kur Shërbimi i Provës konstaton se i mituri nuk përmbush detyrimet që rrjedhin nga masa alternative e shmangies nga ndjekja penale, merr masat, si më poshtë vijon:

a) verifikon faktet dhe rrethanat që ndikojnë në mospërbushjen prej të miturit të detyrimeve nga masa alternative e shmangies nga ndjekja penale;

b) fton të miturin, prindërit e tij ose kujdestarin/përfaqësuesin ligjor në takim, me qëllim diskutimin e rrethanave të mospërbushjes së detyrimeve që burojnë nga masa alternative e shmangies, i cili mbahet brenda 3 (tri) ditëve nga data e dërgimit dhe njoftimit të ftesës për takim. Në njoftim tregohet vendi, data dhe ora e takimit, emri i punonjësit të Shërbimit të Provës, si dhe numri i telefonit dhe adresa e Shërbimit të Provës. Njoftimi kryhet me mjete teknike të përshtatshme që garantojnë njoftimin, si: telefoni, telegrafi, telegrami, faksi apo posta elektronike. Njoftimi ka vlerë kur i mituri dhe prindërit e tij konfirmojnë marrjen e tij;

c) kur, për arsye objektive, i mituri dhe prindërit ose kujdestari/përfaqësuesi ligjor nuk mund të jetë i pranishëm në takim, ai njofton paraprakisht punonjësën e Shërbimit të Provës, duke parashtruar arsyet e mungesës. Në këtë rast punonjësi i Shërbimit të Provës cakton një takim të dytë, jo më vonë se 4 (katër) ditë nga takimi i parë. Në rast se i mituri dhe prindërit e tij ose kujdestari/përfaqësuesi ligjor nuk paraqiten edhe në takimin e dytë, atëherë punonjësi i Shërbimit të Provës njofton menjëherë prokurorin;

ç) mbajtjen e procesverbalit, i cili përshkuan në mënyrë të hollësishme shkaqet e mbajtjes së tij, tregimin e fakteve dhe rrethanave që Shërbimi i Provës ka për mospërbushjen e masës alternative të shmangies nga ndjekja penale nga i mituri dhe prapësimet e bëra nga i mituri, prindërit ose kujdestari/përfaqësuesi ligjor dhe evidentimin e pranisë së psikologut. Procesverbali nënshkruhet nga të gjitha palët pjesëmarrëse në takim, përfshirë edhe psikologun.

5. Brenda 5 (pesë) ditëve nga zhvillimi i takimit, punonjësi i Shërbimit të Provës ka detyrimin të kryejë të gjitha verifikimet e mundshme të shkaqeve dhe rrethanave të mospërbushjes së detyrimeve që burojnë nga masa alternative e shmangies nga ndjekja penale për të miturin dhe,

mbi këtë bazë, harton raportin e vlerësimit. Raporti i vlerësimit përmban:

a) urdhrin e lëshuar nga organi procedues për masën alternative të shmangies nga ndjekja penale dhe kopje të marrëveshjes me detyrimet përkatëse, që janë urdhëruar për t'u përmbushur nga i mituri;

b) kohën, vendin dhe rrethanat e mospërbushjes së detyrimit të masës alternative për shmangie nga ndjekja penale e të miturit, përshkrimin dhe analizën e të miturit, duke përfshirë informacionin për gjendjen e tij sociale, historinë personale, arsimimin, punësimin apo trajnimet, strehimin, shëndetin fizik apo mendor, vështirësitë personale, gjendjen financiare, qëndrime të përgjithshme shoqërore dhe çdo faktor tjetër që punonjësi i Shërbimit të Provës e konsideron të rëndësishëm;

c) përmbledhje të të gjithë informacionit dhe fakteve të rastit të paraqitura në formën e një analize për shkakun e mospërbushjes së detyrimeve të masës alternative të shmangies nga ndjekja penale e të miturit;

ç) analizën, nëse kjo shmangie e këtyre detyrimeve është kryer me apo pa qëllim nga ana e të miturit;

d) burimet e informacionit të përdorura për të përgatitur raportin, duke përfshirë personat e intervistuar dhe dokumentet e konsultuara;

dh) përfundimet dhe rekomandimet e Shërbimit të Provës për prokurorin, në referim të pikës 1, të nenit 71, të ligjit nr. 37/2017.

6. Kundër veprimeve të punonjësit të Shërbimit të Provës të caktuar me mbikëqyrjen e masës alternative të shmangies nga ndjekja penale, i mituri, prindërit ose kujdestari /përfaqësuesi ligjor i tij ka të drejtën e ankimit tek eprori i punonjësit ose te prokurori i çështjes që ka caktuar masën alternative të shmangies.

7. Raporti i vlerësimit për mospërbushjen e masës alternative të shmangies nga ndjekja penale e të miturit përpilohet sipas modeleve të miratuara nga ministri i Drejtësisë, me propozimin e drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit të Provës.

8. Raportit të vlerësimit për mospërbushjen e masës alternative të shmangies nga ndjekja penale nga i mituri i bashkëlidhet edhe kopje e procesverbalit të mbajtur sipas pikës 4, të këtij vendimi, dhe çdo dokument apo e dhënë tjetër që punonjësi i Shërbimit të Provës e gjykon të nevojshme.



9. Nëse i mituri, për të cilin është kërkuar raporti i vlerësimit për mospërbushjen e masës alternative të shmangies nga ndjekja penale, nuk bashkëpunon, punonjësi i Shërbimit të Provës e përmend refuzimin e bashkëpunimit në raportin e vlerësimit.

10. Kopja e raportit të vlerësimit për mospërbushjen e masës së alternative të shmangies nga ndjekja penale u dërgohet edhe të miturit, prindërve ose kujdestarit/përfaqësuesit ligjor të të miturit.

11. Të dhënat për të miturin, që nuk përmbush masën alternative të shmangies nga ndjekja penale, mbahen në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.

12. Të dhënat për procedurën e ndjekur për mospërbushjen nga ana e të miturit të masës alternative të shmangies nga ndjekja penale mund t'u jepen ministrit të Drejtësisë, drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit të Provës, të miturit, prindërve të tij, kujdestarit/përfaqësuesit ligjor, në përputhje me legjislacionin në fuqi për klasifikimin e akteve dhe për mbrojtjen e të dhënave personale.

13. Ngarkohen Ministria e Drejtësisë dhe Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Provës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Erion Braçe

VENDIM
Nr. 149, datë 20.3.2019

**PËR KRIJIMIN, ORGANIZIMIN,
FUNKSIONIMIN, KARAKTERISTIKATË
PËRDORIMIT E AKSESIMIT, TË
DHËNAT PARËSORE E DYTËSORE DHE
DHËNËSIN E INFORMACIONIT TË
SISTEMIT TË INTEGRUAR TË TË
DHËNAVE TË DREJTËSISË PENALE
PËR TË MITUR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 4, të nenit 137, të ligjit nr. 37/2017, “Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur”, dhe të nenit 4, të ligjit nr. 10325, datë 23.9.2010, “Për bazat e të dhënave shtetërore”, me propozimin e ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Përcaktimin e rregullave lidhur me krijimin, organizimin, funksionimin dhe karakteristikat e përdorimit e aksesimit, të dhënat parësore e dytësore dhe dhënësin e informacionit të Sistemit të Integruar të të Dhënave të Drejtësisë Penale për të Mitur.

2. Sistemi i Integruar i të Dhënave të Drejtësisë Penale për të Mitur përmban të dhëna elektronike të përditësuara mbi çdo fazë të procedimit penal, përfshirë edhe ekzekutimin e vendimit penal, ku përfshihen të miturit në konflikt me ligjin penal, të mitur viktimë dhe dëshmitarë të veprave penale.

3. Përdorimi dhe aksesimi i Sistemit të Integruar të të Dhënave të Drejtësisë Penale për të Miturit mbështetet në:

a) parimin e respektimit të jetës private, të dinjitetit dhe personalitetit të të miturit;

b) parimin e konfidencialitetit, duke mos bërë publike asnjë të dhënë ose informacion të marrë për shkak të detyrës/gjatë kryerjes së detyrës dhe pas përfundimit të saj, që mund të lidhet me dënimet e mëparshme të të miturit, në respektim të legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale;

c) parimin e interesit më të lartë të të miturit.

4. Krijimi, funksionimi dhe administrimi i Sistemit të Integruar të të Dhënave të Drejtësisë Penale për të Mitur bëhet në formatin “web-based”.

5. Sistemi i Integruar i të Dhënave të Drejtësisë Penale për të Mitur, si bazë të dhënash shtetërore, hostohet në serverët e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit (në vijim, “AKSHI”).

6. Sistemi i Integruar i të Dhënave të Drejtësisë Penale për të Mitur përmban rubrika të posaçme për anonimizimin e të dhënave, që identifikojnë të miturin në konflikt me ligjin, të miturin viktimë ose dëshmitar të një veprë penale, të dhëna sensitive të lidhura me emrat, adresat, vendet e shkollimit dhe/ose të punës, të profesioneve ose çdo informacion tjetër që mund të përdoret për të identifikuar të miturin.

7. Sistemi i Integruar i të Dhënave të Drejtësisë Penale për të Mitur ka për qëllim, si më poshtë vijon:

a) mbledhjen e të dhënave dhe harmonizimin e



statistikave të rasteve të drejtësisë penale për të mitur në kohë reale, nëpërmjet gjurmimit të të dhënave të ndjekjes penale e procedurave gjyqësore;

b) përmirësimin e cilësisë së statistikave të harmonizuara, të gjeneruara nga institucionet e parashikuara nga ky vendim;

c) unifikimin dhe kompjuterizimin e të dhënave për rastet e drejtësisë penale për të mitur, me qëllim krijimin e një baze statistikore, që ndihmon analizën e orientimin e përmirësimit të politikave lidhur me drejtësinë penale për të mitur;

ç) ofrimin e zgjidhjeve të menjëhershme për rastet kur i mituri është subjekt i abuzimeve ose shkeljeve të garancive procedurale të parashikuara nga legjislacioni në fuqi.

8. Sistemi i Integruar i të Dhënave të Drejtësisë Penale për të Mitur është një sistem unik digjital, që gjeneron tregues bazë në mënyrë sintetike, për:

a) gjendjen e kriminalitetit për të miturit;

b) numrin e përsëritësve nga grup-moshat e mitura;

c) shkallën e riintegritetit apo rehabilitimit të të miturve pas kryerjes së dënimit me burgim ose në rastet kur nuk janë dënuar me burg;

ç) numrin e të miturve në konflikt me ligjin të proceduar në gjendje lirë, të arrestuar, të ndaluar;

d) numrin e të miturve në konflikt me ligjin, të trajtuar me procedurën e shmangies nga ndjekja penale dhe nga dënimi përmes masave alternative;

dh) numrin e të miturve në konflikt me ligjin, të gjykuar e të dënuar;

e) llojin e veprave penale të kryera nga të mitur;

ë) numrin e viktimave të mitura dhe llojin e veprave penale të kryera ndaj tyre; si dhe

f) të dhëna të tjera që lidhen me të miturit në konflikt me ligjin.

9. Sistemi i Integruar i të Dhënave të Drejtësisë Penale për të Mitur përbëhet nga tërësia e të dhënave që burojnë nga fashikujt e dokumente të krijuara, të dërguara dhe të përpunuara gjatë veprimtarisë së institucioneve shtetërore ose joshtetërore, të personave juridikë e fizikë privatë, gjatë procedurave që ndiqen në hetimin ose gjykimin e çështjeve që lidhen me të miturit në konflikt me ligjin, të miturin viktimë dhe/ose dëshmitar. Në të dhënat e detyrueshme, që organet kompetente duhet të hedhin në version elektronik, të jenë:

a) vendimet e gjykatave;

b) vendimi i prokurorit për fillimin, mosfillimin ose shmangien nga ndjekja penale;

c) marrëveshja e shmangies nga ndjekja penale;

ç) raportet e vlerësimit individual të të miturit;

d) vendimet për ekzekutimin e vendimeve penale;

dh) dokumentet që vërtetojnë përmbushjen e detyrimeve të marra përsipër nga i mituri me marrëveshje, si: dëftesa shkollore, vërtetime për ndjekjen e programeve, si dhe akte të tjera;

e) lloji i veprës penale të evidentuar, si dhe të dhëna për identitetin, gjininë, arsimin dhe vendbanimin për të miturit në konflikt me ligjin, të miturit viktimë dhe/ose dëshmitarë;

10. Sistemi i Integruar i të Dhënave të Drejtësisë Penale për të Mitur përmban të dhëna që ndahen në të dhëna parësore dhe të dhëna dytësore, si më poshtë vijon:

a) Të dhëna parësore konsiderohen të dhënat e administruara nga institucioni përgjegjës dhe që kanë të bëjnë me:

i. të miturit autorë, viktimë apo dëshmitarë të një veprë penale; si dhe

ii. çdo të dhënë tjetër që lidhet me të miturit në konflikt me ligjin.

b) Të dhëna dytësore konsiderohen të dhënat që kanë të bëjnë me:

i. veprat penale të evidentuara nga strukturat qendrore e vendore të Policisë së Shtetit për të miturit në konflikt me ligjin, duke përfshirë: llojin e veprës penale, datën e evidentimit, strukturën policore që e ka evidentuar dhe/ose trajtuar rastin, masën e marrë ndaj të miturit (gjendje e lirë, arrestuar, ndaluar, shpallur në kërkim);

ii. njoftimet dhe kallëzimet e kryera pranë organeve të ndjekjes penale për një vepër penale të dyshuar se është kryer nga një i mitur, duke përfshirë: datën e kallëzimit, prokurorinë ku bëhet kallëzimi, numrin e të miturve, veprën penale të dyshuar se është kryer nga i mituri, vendimin e prokurorisë;

iii. të dhënat që merren nga institucionet e ekzekutimit të vendimit, duke përfshirë: dënimin/masën e dhënë, afatin për kryerjen e dënimit/masës, institucionin/zyrën që do ta ndjekë, si dhe të dhëna të tjera që lidhen me procesin;

iv. të dhënat referenciale të gjendjes civile, si: numri personal, emri, mbiemri, atësia, vendlindja, datëlindja, gjinia, bashkia/njësia administrative, adresa;



v. procesin gjyqësor të kryer nga gjykata, duke përfshirë: të dhënat mbi akuzën e ngritur nga prokuroria, datën e numrin e regjistrimit të çështjes, llojin e gjykimit, vendimin e gjykatës, numrin të miturve të dënuar, llojin e dënimit;

vi. të dhënat e marra nga baza të tjera të dhënash, ku ato janë të dhëna parësore.

11. Subjektet përgjegjëse të Sistemit të Integruar të të Dhënave të Drejtësisë Penale për të Mitur janë, si më poshtë vijon:

a) institucioni administrues i sistemit është Ministria e Drejtësisë;

b) institucionet përgjegjëse si dhënës për popullimin me të dhëna sipas fazave të procesit janë:

i. Ministria e Brendshme;

ii. Prokuroria e Përgjithshme;

iii. të gjitha gjykatat/seksionet në nivel rrethi dhe apeli, që gjykojnë çështje penale me të mitur;

iv. Gjykata e Lartë;

v. Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve;

vi. Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Provës.

12. Përdoruesit e Sistemit të Integruar të të Dhënave të Drejtësisë Penale për të Mitur janë hedhësit e informacionit, si më poshtë vijon:

a) Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, drejtoritë vendore të policisë dhe/ose drejtoritë vendore për kufirin dhe migracionin;

b) zyrat/seksionet e prokurorisë në nivel rrethi dhe apeli, që hetojnë çështje penale me të mitur;

c) gjykatat/seksionet në nivel rrethi dhe apeli, që gjykojnë çështje penale me të mitur;

ç) Gjykata e Lartë;

d) Prokuroria e Përgjithshme;

dh) institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale, ku ndodhen të miturit e dënuar ose të paraburgosur;

e) zyrat vendore të shërbimit të provës që trajtojnë rastet e të miturve me masë shmangieje ose masë alternative të dënimit me burgim.

13. Subjekte të interesuara janë:

a) Këshilli i Lartë Gjyqësor;

b) Këshilli i Lartë i Prokurorisë;

c) Inspektori i Lartë i Drejtësisë;

ç) ministria përgjegjëse për arsimin;

d) çdo subjekt tjetër, që paraqet kërkesën e argumentuar pranë ministrit të Drejtësisë dhe i përcaktuar shprehimisht me vendim të Këshillit të Ministrave.

14. Të dhënat lidhur me të miturin dhe procedurën që parashikon ky vendim mbahen në përputhje me rregullat e përcaktuara në legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.

15. Pas lirimit të të miturit, për fashikullin e tij personal elektronik zbatohen rregullat për ruajtjen dhe asgjësimin e fashikujve, të parashikuara nga legjislacioni në fuqi për arkivat.

16. Niveli i aksesit në Sistemin e Integruar të të Dhënave të Drejtësisë Penale për të Mitur është, si më poshtë vijon:

a) subjektet e përcaktuara në pikën 11, të këtij vendimi, kanë të drejtë leximi dhe gjenerimi të të dhënave të hedhura nga përdoruesit e tyre në sistem;

b) subjektet e përcaktuara në pikën 12, të këtij vendimi, kanë të drejtë leximi, shkrimi e modifikimi mbi të dhënat e hedhura prej tyre;

c) subjektet e përcaktuara në pikën 13, të këtij vendimi, kanë akses në nivelin “vizitor” mbi të dhënat që gjenerohen nga sistemi dhe dokumentet e prodhuara, që tregojnë ecurinë procedurale të çështjes, me përjashtim të të dhënave e dokumenteve që përmbajnë të dhëna personale të të miturit të mbrojtura nga ligji;

ç) Ministria e Drejtësisë ka të drejta të plota administrative në sistem në këto role:

i. administrator;

ii. raportues;

iii. auditues;

iv. zhvillues.

17. Sistemi i Integruar i të Dhënave të Drejtësisë Penale për të Mitur ndërvepron me bazat e të dhënave ku ato ekzistojnë si të dhëna parësore, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.

18. Institucionet e varësisë dhe/ose drejtoritë rajonale të institucioneve, të cilat nuk kanë akses të drejtpërdrejtë në sistem, sigurojnë që informacioni t’i dërgohet menjëherë organit epror, i cili ka llogari në sistem. Organi epror, nëpërmjet llogarisë së tij, plotëson sistemin në emër të institucionit që ka dërguar të dhënat. Institucionet e varësisë dhe/ose drejtoritë rajonale dhe institucionet eprore marrin të gjitha masat që komunikimi i të dhënave mes tyre dhe hedhja e të dhënave në sistem të përfundojë brenda 24 (njëzet e katër) orëve, po jo më vonë se 48 (dyzet e tetë) orë nga momenti i krijimit të informacionit nga institucioni dërgues. Për raste të veçanta, hedhja e informacionit nuk



mund jetë përtej 72 (shtatëdhjetë e dy) orëve nga momenti i krijimit.

19. Ministria e Drejtësisë kujdeset që të mundësohet grumbullimi i të dhënave, përpunimi i tyre statistikor, analiza dhe përgatitja e raporteve për përmirësimin dhe parandalimin e kriminalitetit, ofrimi i zgjidhjeve të menjëhershme për rastet kur të miturit i mohohet aksesin në drejtësi ose kur nuk zbatohen garancitë procedurale të parashikuara nga legjislacioni në fuqi, si dhe:

a) të vendosë në dispozicion të përdoruesve të sistemit programin për hedhjen e të dhënave në formatin “web-based”;

b) të bashkëpunojë dhe të bashkërendojë punën me AKSHI-n për hostimin e sistemit;

c) të mbikëqyrë dhe të ofrojë asistencë teknike për përdorimin e sistemit;

ç) të vendosë në dispozicion të organeve shtetërore mundësinë e gjenerimit automatik të statistikave nga sistemi për të dhënat e hedhura nga secili institucion;

d) të trajnojë përdoruesit e sistemit lidhur me raportimin, hedhjen e të dhënave dhe përditësimin e tyre, si dhe për administrimin e përshtatshëm të sistemit, sipas qëllimit të përcaktuar në pikën 7, të këtij vendimi;

dh) të propozojë masa për rritjen e efikasitetit të sistemit dhe përmirësimin e tij në të ardhmen.

20. Të gjithë përdoruesit janë përgjegjës për saktësinë dhe përditësimin e të dhënave të hedhura nëpërmjet llogarisë së tyre në Sistemin e Integruar të të Dhënave të Drejtësisë Penale për të Mitur.

21. Subjekti përgjegjës për administrimin e sistemit në cilësinë e “kontrolluesit”, sipas legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale, duhet të dokumentojë masat tekniko-organizative të përshtatura e të zbatuara për garantimin e mbrojtjes së të dhënave personale.

22. AKSHI, si autoriteti rregullator koordinues i bazave të të dhënave shtetërore, regjistron, auditon dhe koordinon ndërveprimin me bazat e të dhënave shtetërore.

23. Përdorimi i Sistemit të Integruar të të Dhënave të Drejtësisë Penale për të Mitur fillon nga data e vënies në funksionim e tij.

24. Ngarkohen institucionet shtetërore, që hedhin të dhënat sipas fushave të veprimtarisë, për miratimin e rregullave të detajuara për përdorimin e sistemit nga institucionet e tyre të varësisë.

25. Ngarkohen Ministria e Drejtësisë, Agjencia e

Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit, Ministria e Brendshme, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë, Prokuroria e Përgjithshme, Këshilli i Lartë Gjyqësor, Gjykata e Lartë, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve dhe Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Provës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Erion Braçe

VENDIM

Nr. 150, datë 20.3.2019

PËR METODOLOGJINË E LLOGARITJES SË FONDEVE PËR FINANCIMIN E SHËRBIMEVE TË KUJDESIT SHOQËROR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 48, pika 2, të ligjit nr. 121/2016, “Për shërbimet e kujdesit shoqëror”, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe të ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. RREGULLA TË PËRGJITHSHME

1. Ky vendim ka për qëllim hartimin e metodologjisë së llogaritjes së fondeve të financimit të shërbimeve sociale e të shpërndarjes së tyre nëpërmjet vendosjes së kriterëve e hapave që do ndjekë procesi.

2. Procesi i realizimit të procedurave të financimit nga buxheti i shtetit të shërbimeve të kujdesit shoqëror, në nivel vendor, do të kryhet si në kuadrin e Fondit Social, ashtu dhe të transfertave të tjera, përfshirë këtu dhe financimin e shërbimeve të specializuara e unike të ofruara nga njësitë e vetëqeverisjes vendore, në nivel qarku, si dhe linjat kombëtare të këshillimit telefonik për gratë e fëmijët, që kanë marrëveshje bashkëpunimi me ministrinë përgjegjëse për çështjet sociale.

3. Në kuptim të këtij vendimi, shërbime të specializuara të kujdesit shoqëror përfshijnë shërbimet në komunitet, ato rezidenciale dhe ditore, të specializuara, sipas përcaktimeve të bëra në pikat 6 e 7, të nenit 3, të ligjit nr. 121/2016, “Për shërbimet e kujdesit shoqëror”, si dhe në pikën 12, të vendimit nr. 518, datë 4.9.2018, të



Këshillit të Ministrave, “Për shërbimet e kujdesit shoqëror komunitar dhe rezidencial, kriteret, procedurat për përfitimin e tyre dhe masën e shumës për shpenzime personale për përfituesit e shërbimit të organizuar”.

II. PROCEDURA E LLOGARITJES SË FINANCIMIT TË SHËRBIMEVE TË KUJDESIT SHOQËROR

4. Drejtoria përgjegjëse për shërbimet e kujdesit shoqëror pranë njërive të vetëqeverisjes vendore mbledh e analizon këto të dhëna bazë:

- a) Të dhënat demografike bazë;
 - b) Profilin dhe karakteristikat e kategorive në nevojë për shërbime të kujdesit shoqëror;
 - c) Shërbimet ekzistuese në territorin e bashkisë ose në qarkun ku bën pjesë bashkia përkatëse;
 - ç) Listën e shërbimeve dhe shpërndarjen e tyre në territor;
 - d) Financimin e shërbimeve aktuale;
 - dh) Të dhënat për strukturat që mbështesin apo ofrojnë shërbime të kujdesit shoqëror të ngritura në bashki dhe njësi administrative, në përputhje me ligjin;
 - e) Të dhëna krahasuese për buxhetin e bashkisë për shërbimet e kujdesit shoqëror dhe shpërndarjen e tij në territorin e bashkisë;
 - ë) Listën e shërbimeve shoqërore të munguara në territor.
5. Mbi bazën e të dhënave të mbledhura dhe të analizuar në pikën 3, të këtij vendimi, struktura përgjegjëse e shërbimeve të kujdesit shoqëror në bashki harton raportin e nevojave për shërbime të kujdesit shoqëror (në vijim, “raportin e nevojave”), si dhe planin social për periudhën trivjeçare.
6. Plani social përfshin:
- a) qëllimet specifike;
 - b) objektivat;
 - c) aktivitetet/shportën e shërbimeve/shërbimet specifike që ofrohen në territor;
 - ç) aktorët përgjegjës/njësitë zbatuese për secilin aktivitet;
 - d) afatet e zbatimit për çdo shërbim;
 - dh) treguesit që mundësojnë matjen e realizimit me sukses të aktivitetit/shërbimit;
 - e) referencat ligjore, ku e ka bazën aktiviteti specifik i parashikuar;
 - ë) financimin e aktivitetit/shërbimit që specifikon burimin që e mbështet (buxheti i bashkisë/buxheti kombëtar/donator etj.);
 - f) metodologjinë e monitorimit dhe njësinë e

ngarkuar me monitorimin e zbatimit të aktivitetit dhe treguesit e matjes së performancës së shërbimeve të kujdesit shoqëror; si dhe

g) kostimin/koston për secilin prej aktiviteteve të përfshira në planin social.

7. Struktura përgjegjëse për shërbimet e kujdesit shoqëror në bashki bashkërendon planet sociale të njërive administrative në territorin e saj dhe, nëse vlerëson që ekzistojnë kushtet që një apo disa shërbime mund të përmbushin nevojat e dy apo më shumë njërive administrative, kryen përllogaritjen e koston të aktiviteteve dhe i paraqet këshillit bashkiak propozimin për miratim të planit social, pas konsultimit të tij me grupet e interesit dhe me Drejtorinë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror.

8. Plani social vendor i çdo njësie të vetëqeverisjes vendore përfshin shërbimet shoqërore ekzistuese dhe shërbimet e reja të kostuara, sipas standardeve të miratuara nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, si dhe burimet përkatëse të financimit të tyre.

9. Kostoja e çdo shërbimi indekskohet çdo vit, në bazë të inflacionit zyrtar të llogaritur nga Instituti i Statistikave.

10. Këshilli bashkiak miraton planin social trevjeçar të buxhetuar, si dhe kërkesën për financim (fonde) nga buxheti i shtetit, brenda muajit shkurt të çdo viti, për atë pjesë të planit që mbetet i pambështetur nga buxheti i bashkisë.

11. Njësitë e vetëqeverisjes vendore, bazuar në planet sociale vendore të miratuara nga këshillat bashkiakë, përgatisin kërkesat për financim të Fondit Social nga buxheti i shtetit i vitit të ardhshëm, në kuadër të programit buxhetor afatmesëm. Kërkesat për financim të Fondit Social nga buxheti i shtetit, shoqëruar me planin social vendor të miratuar, i dërgohen ministrisë përgjegjëse për çështjet sociale brenda muajit mars të çdo viti.

12. Ministria përgjegjëse për çështjet sociale, duke u bazuar në planet sociale vendore të buxhetuara dhe në prioritetet kombëtare për shtrirjen e shërbimeve shoqërore, parashikon në buxhetin e saj të vitit të ardhshëm, fonde për financimin e Fondit Social.

13. Fondi Social i alokuar nuk mund të transferohet në programe të tjera apo të përdoret për financimin e aktiviteteve të ndryshme nga ato të përcaktuara në pikën 2, të këtij vendimi. Në të



kundërt, njësia e vetëqeverisjes vendore nuk përfiton fonde për shërbime shoqërore për vitin pasardhës.

14. Bashkitë mund të mbartin në buxhetin e vitit pasardhës mjetet financiare të Fondit Social të përdorura në vitin fiskal ushtrimor, përjashtuar financimin nga buxheti i shtetit.

15. Këshilli i qarkut, bazuar në planin social rajonal të bashkërenduar me planet sociale të bashkive, vendos ofrimin e shërbimeve të specializuara dhe unike të kujdesit shoqëror të ofruara në nivel qarku.

16. Struktura përgjegjëse për shërbimet e kujdesit shoqëror, në nivel qarku, çdo fund viti, mbledh kërkesat për mundësi financimi nga buxheti i shtetit, të sjella nga organizatat jofitimprurëse, që ofrojnë shërbime të specializuara të kujdesit shoqëror, në nivel bashkie/qarku.

17. Kërkesa për mundësi financimi, sipas pikës 16, të këtij vendimi, shoqërohet me projekt-propozimin për ofrimin e shërbimeve të specializuara dhe unike të kujdesit shoqëror, bazuar në standardet kombëtare të miratuara. Në projekt përcaktohen të gjithë komponentët e nevojshëm, si: ambientet, personeli, numri i mundshëm i përfituesve, masa e kërkuar për financimin, raportin e përdorimit të financimit nga buxheti i shtetit apo buxheti lokal apo nga donatorë të ndryshëm, raporte monitorimi ose vlerësimi të brendshme, të institucioneve publike ose të pavarura të cilësisë së ofrimit të shërbimit, kur bëhet fjalë për vazhdimësi financimi.

18. Strukturat përgjegjëse për shërbimet e kujdesit shoqëror në nivel qarku, brenda 10 (dhjetë) ditëve pas marrjes së kërkesës, fillojnë procedurat e vlerësimit, sipas përcaktimeve të bëra në nenet 36–38, të ligjit për shërbimet e kujdesit shoqëror, të cilat konsiderohen si parësore nga njësitë e vetëqeverisjes vendore, por që nuk mund të ofrohen prej tyre në kuadër të Fondit Social.

19. Strukturat përgjegjëse për shërbimet e kujdesit shoqëror, në nivel qarku, nisur nga vlerësimi i bërë, sipas përcaktimeve të pikës 4, të këtij vendimi, përgatisin dokumentacionin dhe propozimin për mundësinë e mbështetjes financiare nga buxheti i shtetit për miratim nga këshilli i qarkut.

20. Vendimi i këshillit të qarkut i paraqitet, shoqëruar me kërkesë për financim nga buxheti i shtetit, brenda tremujorit të parë të vitit pasardhës,

ministrisë përgjegjëse për çështjet sociale.

21. Ministri përgjegjës për çështjet sociale ngrë komisionin për vlerësimin e kërkesave për mundësitë e financimit nga buxheti i shtetit, për organizatat jofitimprurëse, që ofrojnë shërbime të specializuara të kujdesit shoqëror, në nivel qarku.

22. Komisioni/grupi i punës shqyrton dhe vendos për propozimet e ardhura nga qarqet, brenda 30 (tridhjetë) ditëve, për mundësinë e vazhdimin të financimit të shërbimeve ekzistuese apo të ngritjes së shërbimeve të reja të specializuara dhe unike të kujdesit shoqëror nga buxheti i shtetit, si dhe shkallën e mbulimit të financimit, në bazë të vlerësimit rast pas rasti dhe të kriterit të nevojës më të madhe.

23. Në përfundim, komisioni/grupi i punës përgatit dhe dorëzon, për miratim, pranë ministrit përgjegjës për çështjet sociale, relacionin me gjetjet dhe rekomandimet përkatëse për garantimin e qëndrueshmërisë së shërbimeve të specializuara të kujdesit shoqëror, për grupet në nevojë, në nivel qarku.

24. Ministria përgjegjëse për çështjet sociale parashikon në buxhetin e saj fondin e nevojshëm për financimin e tyre në formën e transfertave të kushtëzuara, në kuadër të programit buxhetor afatmesëm, të cilat i transferohen pushtetit vendor, ku funksionojnë/do të funksionojnë këto shërbime.

25. Ministri përgjegjës për çështjet sociale, pas miratimit të kërkesave të paraqitura, autorizon njësinë përgjegjëse për shërbimet shoqërore, në nivel qarku, të lidhin kontratën me organizatat jofitimprurëse për financimin e shërbimeve shoqërore pa pagesë në territorin e qarkut.

III. METODOLOGJIA E SHPËRNDARJES SË FONDEVE BUXHETORE

26. Shpërndarja e fondeve buxhetore për financimin e Fondit Social të njësive të vetëqeverisjes vendore kryhet nga ministria përgjegjëse për çështjet sociale, duke u bazuar në:

- a) kriterin e nevojës më të madhe;
- b) impaktin dhe prioritetet e çdo njësie të qeverisjes vendore në ofrimin e këtyre shërbimeve sipas planeve përkatëse sociale;
- c) mundësitë e financimit nga buxheti i shtetit;
- ç) shkallën e mbulimit të financimit të Fondit Social nga burime të tjera nga buxheti i shtetit;
- d) qëndrueshmërinë financiare të modelit të financimit të shërbimeve.



27. Për përcaktimin e kriterit të nevojës më të madhe (pika III.1.a e këtij vendimi), për çdo njësi të vetëqeverisjes vendore, ministria përgjegjëse për çështjet sociale bazohet në të dhënat e disponueshme nga vetë institucioni, si dhe nga Instituti i Statistikave, njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe Shërbimi Social Shtetëror për parametrat e mëposhtëm:

- a) Numrin e popullsisë (10%);
- b) Shkallën e papunësisë (15%);
- c) Numrin e përfituesve të ndihmës ekonomike (15%);
- ç) Numrin e personave me aftësi të kufizuara (20%);
- d) Numrin e kërkesave për strehim social (10%);
- dh) Numrin e shërbimeve sociale të ofruara (10%);
- e) Numrin e përfituesve të shërbimeve sociale të ofruara (10%);
- ë) Numrin e organizatave që ofrojnë shërbime sociale (5%);
- f) Ofrimin e shërbimeve të reja sipas shportës së miratuar të shërbimeve (5%).

28. Financimi i shërbimeve të përkujdesjes shoqërore nga buxheti i shtetit, nëpërmjet Fondit Social, do të mbështesë propozimet për krijimin e shërbimeve të reja bazuar në planet sociale të miratuara, duke garantuar qëndrueshmërinë e tyre në kohë dhe duke synuar reduktimin gradual të mbështetjes së tyre nga buxheti i shtetit.

29. Për të mundësuar vazhdimësinë e ofrimit të këtyre shërbimeve, krijimin e shërbimeve të tjera dhe shtrirjen e tyre në të gjithë territorin e vendit, financimi nga buxheti i shtetit do të mbështesë:

- a) jo më shumë se 90% të kostos për vitin e parë të ofrimit të shërbimeve;
- b) jo më shumë se 60% të kostos për vitin e dytë të ofrimit të shërbimeve;
- c) 30% në vitet në vijim.

30. Përjashtim nga rregulli i përcaktuar në pikat 28 e 29, të këtij vendimi, bëjnë qendrat kombëtare të përkujdesjes sociale, qendrat që ofrojnë shërbime të specializuara dhe unike, në nivel qarku, dhe linjat kombëtare të këshillimit telefonik për gratë dhe fëmijët, që kanë marrëveshje bashkëpunimi/kontratë me ministrinë përgjegjëse për çështjet sociale.

IV. OFRIMI DHE MONITORIMI I SHËRBIMEVE TË KUJDESIT SHOQËROR

31. Shërbimet e përkujdesjes shoqërore, të parashikuara në vendimin nr. 518, datë 4.9.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për shërbimet e kujdesit shoqëror komunitar dhe rezidencial, kriteret, procedurat për përfitimin e tyre dhe masën e shumës për shpenzime personale për përfituesit e shërbimit të organizuar”, të cilat konsiderohen si parësore nga njësia e vetëqeverisjes vendore, por që nuk mund të ofrohen prej saj, mund të ofrohen nga organizata jofitimprurëse, që operojnë në këtë fushë.

32. Njësia e vetëqeverisjes vendore harton specifikimet teknike, bazuar në standardet e miratuara nga ministria përgjegjëse për çështjet sociale, për të organizuar dhe për të hapur tenderin e shërbimeve të kujdesit shoqëror, kur ato ofrohen nga persona juridikë privatë.

33. Njësia e vetëqeverisjes vendore prokuron shërbimet e kujdesit shoqëror, në përputhje me rregullat e prokurimit publik dhe lidh kontratat me ofruesit jopublikë/organizatat jofitimprurëse.

34. Ofruesit jopublikë/organizatat jofitimprurëse të kontraktuara nga njësia e vetëqeverisjes vendore ofrojnë shërbimet e kujdesit shoqëror, si pjesë e kontratës ose e marrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet palëve.

35. Njësia e vetëqeverisjes vendore raporton, çdo katër muaj, lidhur me ofrimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror, financuar nga Fondi Social, pranë drejtorive rajonale të shërbimit social shtetëror.

36. Njësia e vetëqeverisjes vendore monitoron ofrimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror, të përcaktuara në pikën 3, të këtij vendimi, sipas standardeve e treguesve të performancës, të përcaktuara në marrëveshjen e bashkëpunimit/kontratën me organizatat jofitimprurëse/ofruesit jopublikë.

37. Shërbimi Social Shtetëror monitoron zbatimin e standardeve kombëtare nga njësitë e qeverisjes vendore dhe ofruesit e shërbimeve të kujdesit shoqëror, që financohen pjesërisht apo tërësisht nga buxheti i shtetit dhe informon ministrinë përgjegjëse për çështjet sociale, si dhe jep rekomandime për njësitë e qeverisë vendore përgjegjëse.

38. Inspektorati që mbulon fushën e shërbimeve të kujdesit shoqëror, në përputhje



me funksionet dhe kompetencat e parashikuara në nenin 35, të ligjit për shërbimet e kujdesit shoqëror, siguron zbatueshmërinë e standardeve të shërbimeve shoqërore të ofruara nga subjektet e kontraktuara nga njësitë e vetëqeverisjes vendore.

39. Ministria përgjegjëse për çështjet sociale, nëpërmjet strukturave përgjegjëse, siguron auditimin financiar të shërbimeve të kujdesit shoqëror, që financohen pjesërisht apo tërësisht nga buxheti i shtetit.

V. DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

40. Deri në miratimin e standardeve kombëtare të shërbimeve të përkujdesjes sociale, llogaritja e kostove për shërbime bëhet në bazë të standardeve ekzistuese apo rast pas rasti, nëse për shërbimin nuk ekzistojnë standarde.

41. Deri në kalimin e shërbimeve rezidenciale kombëtare në administrim të njëjësive të vetëqeverisjes vendore, ministria përgjegjëse për mbrojtjen sociale, gjatë procesit të hartimit të programit buxhetor afatmesëm dhe buxhetit vjetor, parashikon fondet e nevojshme për këto shërbime dhe i propozon ministrisë përgjegjëse për financat shumën financiare për vijimin e aktivitetit të tyre.

42. Ngarkohen ministria përgjegjëse për çështjet sociale, në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për financat, të udhëzojnë njësitë e qeverisjes vendore për financimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror.

43. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe strukturat përgjegjëse për shërbimet e kujdesit në njësitë e vetëqeverisjes vendore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDESKRYEMINISTRI
Erion Braçe

VENDIM

Nr. 151, datë 20.3.2019

PËR HEQJEN NGA FONDI PYJOR PUBLIK DHE ZVOGËLIMIN NË VOLUM TË SIPËRFAQES PREJ 1.1833 HA, NË OBJEKTIN “MAJA E MIDHËS”, TË BASHKISË FUSHË-ARRËZ, QË DO TË PËRDORËT NGA MINISTRIA E MBROJTJES PËR NDËRTIMIN E RADARIT SIVHA

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 17, të ligjit nr. 9385, datë 4.5.2005, “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Turizmit dhe Mjedisit dhe të ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Sipërfaqja pyjore publike, prej 1.1833 (një pikë një mijë e tetëqind e tridhjetë e tre) ha, që do të përdoret për kryerjen e punimeve civile nga kompania “Lockheed Martin Global, Incorporated, USA”, për ndërtimin e radarit SIVHA, në objektin “Maja e Midhës”, në Bashkinë Fushë-Arrëz, të hiqet nga fondi pyjor publik i bashkisë, të zvogëlohet në volum dhe të çregjistrohet nga Regjistri i Kadastrës së Pyjeve dhe Kullotave. Lidhja nr. 1, me të dhënat për sipërfaqen pyjore që zvogëlohet në volum dhe hiqet nga fondi pyjor publik, si dhe harta topografike me koordinatat e poligonit të sipërfaqes objekt ndërtimi, i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse e tij.

2. Vlera përkatëse e volumit të materialit drusor, produkteve të tjera pyjore dhe investimeve të kryera në vite, në sipërfaqen objekt ndërtimi, kompensohet nga Ministria e Mbrojtjes për Bashkinë Fushë-Arrëz, në bazë të lidhjes 4, të vendimit nr. 391, datë 21.6.2006, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe kullotave”, të ndryshuar.

3. Bashkia Fushë-Arrëz dhe Ministria e Mbrojtjes, si përfituese e ndërtimit të radarit SIVHA, nënshkruajnë marrëveshjen e bashkëpunimit jo më vonë se 60 ditë nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.

4. Sipërfaqet pyjore, sipas lidhjes 1, të këtij vendimi, mbeten pronë publike e shtetit dhe regjistrohen në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Mbrojtjes.



5. Zyra vendore e regjistrimit të pasurive të paluajtshme publike çregjistroi sipërfaqen pyjore të identifikuar sipas lidhjes 1, të këtij vendimi, nga kategoria “Tokë e zënë pyjore” dhe e regjistroi në kategorinë “Tokë e zënë, objekt ndërtimi i radarit SIVHA”.

6. Ngarkohen Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Ministria e Mbrojtjes, Zyra Vendore e Regjistrimit

të Pasurive të Paluajtshme dhe Bashkia Fushë-Arrëz për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI

Erion Braçe

Bashkia FUSHË-ARRËZ

LISTA E NGASTRAVE DHE N/NGASTRAVE TË FONDIT PYJOR PUBLIK QË HIQEN PËR NDËRTIMIN E RADARIT SIVHA NGA MINISTRIA E MBROJTJES

Nr.	ID pronës	Ekonomia pyjore/Kullosore	Ng/n/gast.	Sipërfaqja që hiqet nga fondi pyjor/kullosor ha	Përdorimi territorit
1	2	3	4	5	6
1	SH39 00 031 b	Krrab-Bushat	31 b	0.27	trungishte
2	SH58 00 177 a	Qafë Plakë- Qafë-Sharri	177 a	0.90	trungishte
3	SH58 00 179 a	Qafë Plakë- Qafë-Sharri	179 a	0.01	trungishte
GJITHSEJ				1.183	



HARTA KADASTRALE ME NGASTRAT PYJORE,
PJESA QË KËRROHET TË MERRET NË PRONËSI NGA MINISTERIA E MBROJTJES
SHKALLA 1 : 10000

MIRATOHET
KOMANDANTI I FORCËS AJRORE
Gjeneral Brigade Vladimir AVDIAJ




PUNOI
Topograf Nikoll TUSHI

SQARUESE:
Sip. e Përgjithshme e Pronës = 11833 m²
Kufiri i Pronës



Sipërfaqja që zë prona e Ministrisë së Mbrojtjes sipas parcelave pyjore

Parcela	Sipërfaqja (Ha)
177	0.8977 (8977 m ²)
179	0.011 (110 m ²)
31/b	0.2746 (2746 m ²)
TOTAL	1.1833 (11833 m²)



Sipërfaqja që do të hiqet nga fondi pyjorë dhe që do të kalojë në pronësi Ministrisë së Mbrojtjes

Parcela	Emërtimi	Sipërfaqja (Ha)
177	Sipërfaqja që do të hiqet	0.8977 (8977 m ²)
179	Sipërfaqja që do të hiqet	0.011 (110 m ²)
31/b	Sipërfaqja që do të hiqet	0.2746 (2746 m ²)
Totali i Sipërfaqes		1.1833 (11833 m²)

KOORDINATA E PRONËS QË KALON NË PRONËSI TË
MINISTRISË SË MBROJTJES
SISTEMI I KOORDINATAVE

Nr. Kulmit	UTM, WGS-84		GAUSS - KRYGER	
	X	Y	X	Y
1	4662848.26	415245.24	4 664 846.082	4 415 342.250
2	4662906.82	415375.949	4 664 904.664	4 415 473.013
3	4662900.4	415416.404	4 664 898.246	4 415 513.484
4	4662854.4	415432.987	4 664 852.224	4 415 530.074
5	4662786.6	415268.887	4 664 784.403	4 415 365.907

15'000

16'000

**VENDIM****Nr. 152, datë 20.3.2019****PËR HEQJEN NGA FONDI PYJOR
DHE KULLOSOR PUBLIK DHE
ZVOGËLIMIN NË VOLUM TË
SIPËRFAQES PREJ 12 HA, QË DO TË
PËRDORET NGA “DEVOLL
HYDROPOWER” SHA PËR
SHFRYTËZIMIN E GURIT GËLQEROR
NË OBJEKTIN “POPÇISHT”,
BASHKIA MALIQ**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të shkronjës “b”, të pikës 1, të nenit 17, të ligjit nr. 9385, datë 4.5.2005, “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, të ndryshuar, dhe të shkronjës “b”, të pikës 1, të nenit 10, të ligjit nr. 9693, datë 19.3.2007, “Për fondin kullor”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Turizmit dhe Mjedisit dhe të ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Sipërfaqja pyjore publike prej 12 ha, që do të përdoret nga “Devoll Hydropower” sh.a. për shfrytëzimin e gurit gëlqeror në objektin “Popçisht”, Bashkia Maliq, të hiqet nga fondi pyjor dhe kullor publik i bashkisë, të zvogëlohet në volum dhe të çregjistrohet nga Regjistrimi i Kadastrës së Pyjeve dhe Kullotave. Lidhja nr. 1, me të dhënat për sipërfaqet pyjore që zvogëlohen në volum dhe hiqen nga fondi pyjor dhe kullor publik, si dhe harta topografike me koordinatat e poligonit të sipërfaqes objekt mineral, i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse e tij.

2. Vlerat përkatëse të volumit të materialit drusor, të produkteve të tjera pyjore dhe kullor dhe të investimeve të kryera në vite, në sipërfaqen objekt mineral, paguhen nga “Devoll Hydropower” sh.a., në llogarinë rrjedhëse të Bashkisë Maliq, në bazë të lidhjes 4, të vendimit nr. 391, datë 21.6.2006, të Këshillit të Ministrave,

“Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe kullotave”, të ndryshuar.

3. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, “Devoll Hydropower” sh.a. detyrohet të rehabilitojë sipërfaqet sipas kushteve të lejes mjedisore dhe të pyllëzojë, me fondet e veta, një sipërfaqe pyjore prej 12 ha, në ngastrat e përcaktuara në marrëveshje me Bashkinë Maliq.

4. Bashkia Maliq dhe “Devoll Hydropower” sh.a. nënshkruajnë marrëveshjen e bashkëpunimit jo më vonë se 60 ditë, nga hyrja në fuqi e këtij vendimi. Një kopje e marrëveshjes, së bashku me projektin e miratuar për pyllëzimin, dërgohet në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit, jo më vonë se 10 ditë, nga data e nënshkrimit të saj.

5. Sipërfaqet pyjore, sipas lidhjes nr. 1, të këtij vendimi, mbeten pronë publike e shtetit dhe regjistrohen në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë.

6. Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme bën çregjistrimin e sipërfaqes pyjore të identifikuar sipas lidhjes nr. 1, të këtij vendimi, nga kategoria “Tokë pyjore” dhe e regjistron në kategorinë “Tokë e zënë, objekt shfrytëzimi për aktivitetet mineral”.

7. Me përmbushjen e detyrimeve të përcaktuara në planin e rehabilitimit sipas lejes mjedisore nga “Devoll Hydropower” sh.a., sipërfaqja e rehabilituar të regjistrohet në fondin pyjor dhe kullor publik të Bashkisë Maliq.

8. Ngarkohen Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Bashkia Maliq dhe “Devoll Hydropower” sh.a. për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.


ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Erion Braçe



Bashkia MALIQ

**LISTA E NGASTRAVE DHE N/NGASTRAVE TË FONDIT PYJOR DHE KULLOSOR PUBLIK QË HIQEN
PËR KRYERJEN E AKTIVITETIT MINERAR TË SHOQËRISË "DEVOLL HYDROPOWER" sh.a.**

Nr.	ID Pronës	Ekonomia Pyjore/Kullosore	Ngastra n/ngastra	Sipërfaqja që hiqet nga fondi pyjor/ kullosor HA	Përdorimi territorit
1	2	3	4	5	6
1	KO 048 00 031a	EP Moglicë	31 a	12.00	cungishte
GJITHSEJ				12.00	





VENDIM

Nr. 153, datë 20.3.2019

**PËR DHËNIEN E STATUSIT TË
VEÇANTË “INVESTITOR NË
STRUKTURË AKOMODUESE ME 5 YJE,
STATUS SPECIAL”, APLIKUESIT
“TIRANA BUSINESS PARK” SHPK**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 33/1, të ligjit nr. 93/2015, “Për turizmin”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Turizmit dhe Mjedisit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Dhënie e statusit të veçantë “Investitor në strukturë akomoduese me 5 yje, status special”, aplikuesit “Tirana Business Park” sh.p.k.

2. Ngarkohet Ministria e Turizmit dhe Mjedisit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI

Erion Braçe

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2019

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 392 lekë